# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6033
E mërkurë, 10 qershor 2020
çmimi 0.40 €


## Deri në vjeshtë do të kompensohen bizneset dhe familjet që pësuan nga Covid-19

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ FAQE 4-5

# QEVERIA E RE DO TA KTHEJË KOSOVËN NË BINARËT E DUHUR



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, është shpre-hur i bindur se qeveria e re do ta kthejë Kosovën në binarët e duhur. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se qeverinë Hoti e presin sfida të shumta si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm. Deputeti i AAK-së ka deklaruar se kjo qeveri ka për detyrë t'i rikuperojë raportet me ShBA-të dhe ta filloje rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës. Sipas tij, në procesin e dialogut me Serbinë, Kosovës i duhet uniteti i spektrit institucional dhe politik



## MË 19 QERSHOR AFATI I FUNDIT PËR DEKLARIMIN E PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIKË

FAQE 3

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) u ka bërë thirrje të gjithë zyrtarëve të lartë publikë që deklarimin e pasurisë ta bëjnë deri më 19 qershor, në të kundërtën për të gjithë zyrtarët që nuk u përgjigjen obligimeve ligjore për deklarimin e pasurisë, AKK-ja do të ndërmarrë veprime ligjore konform mandatit dhe ligjeve në fuqi

## ASHAK-u KËRKON TRANSPARENCË PËR DIALOGUN ME SERBINË

FAQE 6



### OPINION

MOS MERRNI VENDIME TË SHPEJTA, SE EDHE MË SHPEJT DO TA THYENI QAFEN! F. 7

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



### AKTUALE

VETËVENDOSJA KËRKON INTERPELANCË PAS HEQJES SË MASAVE TË RECIPROCITETIT F. 5

KRYEMINISTRI HOTI ZOTOHET PËR TRAJTIM DINJITOZ TË KATEGORIVE TË DALA NGA LUFTA F. 7

### EKONOMI

PANDEMIA COVID-19 RRETH 700 MIJË UDHËTARËVE UA PAMUNDËSOI FLUTURIMET F. 9

### KULTURË

DR. ERMIRA BABAMUSTA RRËFEN PËR BESIMIN POLITIK NË KOSOVË F. 13



### SPORT



PËRKUJTOHET EMBLEMA E FUTBOLLIT TË KOSOVËS, FADIL VOKRRI F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kryeministri Avdullah Hoti ka prezantuar masat e pakos së rimëkëmbjes

# Deri në vjeshtë do të kompensohen bizneset dhe familjet që pësuan nga Covid-19



"Orientimet tona janë që deri në vjeshtë të këtij viti t'i kompensojmë bizneset dhe familjet së paku për pjesën që kanë pësuar si rezultat i pandemisë, pastaj t'i vëmë në praktikë masat që na mundësojnë që në pjesën e mbetur të këtij viti, në veçanti gjatë vitit 2021, të hyjmë në projekte zhvillimore të natyrës më afatgjatë", ka thënë kryeministri Avdullah Hoti me rastin e prezantimit të nëntë masave që janë paraparë në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të martën në një takim përfaqësuesit e Asociacioneve të Bizneseve, përfaqësuesit e BQK-së dhe të Asociacionit të Komunave të Kosovës, me të cilët ka diskutuar rreth Pakos për Rimëkëmbjen Ekonomike si dhe për masat e rimëkëmbjes ekomomike të cilat janë miratuar në qeveri si pjesë të programit qeverisës. "Ju garantoj se do të punojmë bashkë për përgatitjen e planit për zbatimin e këtyre masave dhe pasurimin e këtyre masave për t'u realizuar në praktikë. Ne i kemi bërë disa analiza paraprake dhe është një vlerësim i përgjithshëm se ekonomia e Kosovës ka pësuar rreth 5 për qind të brutoproduktit të brendshëm si rezultat i pandemisë. Masat që i kemi paraparë në periudhën afatshkurtër do të koncentrohen që ne sa më parë që është e mundur të kompensojmë këtë rënie ekonomike dhe ta kthejmë ekonominë aty ku ka qenë para pandemisë", tha kryeministri Hoti, duke theksuar se këto masa krijojnë mundësi për ta vendosur ekonominë e Kosovës në një trajektore krejt tjetër të zhvillimit ekonomik afatgjatë.

Duke theksuar se e gjithë kjo mund të arrihet nëse i bëjmë bashkë forcat dhe përpjekjet tona, kryeministri Hoti ka garantuar se si qeveri do ta kenë mbështetjen dhe bashkëpunimin e nevojshëm për t'i dizajnuar më në hollësi këto masa. "Gjatë fazës së implementimit do të punojmë bashkë për t'u siguruar se këto fonde do të shkojnë në vendin e duhur, atje ku japin efektin maksimal. Mbi të gjitha, këto masa nuk interferojnë shumë në parimet bazike të konkurrencës, gjithmonë duke i respektuar udhëzimet e Komisionit Evropian dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare sa iu përket ndërhyrjeve në ekonomi që po i bëjnë qeveritë e ndryshme", tha kryeministri Hoti.

Më tej, kryeministri Hoti tha se do të shihet mundësia e funksionalizimit të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, ku do të jenë të përfshira të gjitha palët me interes dhe ka shtuar se orientimi i qeverisë është krijimi i bazës ligjore përmes Ligjit të Buxhetit për krijimin e një fondi në të cilën bëhen bashkë një pjesë e konsiderueshme e mjeteve nga Buxheti i Kosovës përmes identifikimit të kursimeve të ndryshme ose nga projekte që nuk kanë pasur mundësi të zbatohen për shkak të pandemisë dhe mjete të tjera për të cilat është dhënë zotimi nga partnerët zhvillimorë, duke filluar nga Komisioni Evropian, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe partnerë të tjerë zhvillimorë që do të kontribuojnë në fondin për rimëkëmbjen ekonomike. "Orientimet tona janë që deri në vjeshtë të këtij viti ne t'i kompensojmë bizneset dhe familjet së paku për pjesën që kanë pësuar si rezultat i pandemisë dhe pastaj t'i vëmë në praktikë masat që na mundësojnë që në pjesën e mbetur të këtij viti, në veçanti gjatë vitit 2021, të hyjmë në projekte zhvillimore të natyrës më afatgjatë", tha kryeministri Hoti.

Kryeministri Hoti me këtë rast ka prezantuar 9 masat që janë paraparë në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike: 1. Lehtësimi i qasjes në financim; 2. Zvogëlimi i barrës tatimore; 3. Masat për mbështetje të punësimit; 4. Bujqësia; 5. Masat për stimulim të kërkesës agregate; 6. Mbështetje për ndërmarrje publike për operim të rregullt dhe investime kapitale të rëndësisë strategjike; 7. Rishikimi i Buxhetit për 2020-n dhe relaksimi i kufizimeve fiskale dhe i borxhit publik; 8. Masa mbështetëse për ekonomi nga sektori financiar; 9. Mobilizimi për financimin e masave.

## Shqipëria regjistron 36 raste të reja me Covid-19

TIRANË, 9 QERSHOR - Në Shqipëri është rritur numri i personave të infektuar me Covid-19. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, në 24 orët e fundit janë regjistruar 36 raste të reja me këtë virus, numër rekord që nga përhapja e pandemisë në vend.

Silva Bino nga Instituti i Shëndetit Publik ka bërë me dije se shkak për rritjen e numrit të të prekurve janë bërë grumbullimet masive dhe mosrespektimi i masave. "Situata e Covid-19 është përkeqësuar, rastet janë shtuar dhe sot kemi 36 raste. 27 raste i përkasin Tiranës. Kjo situatë nuk ishte kaq e papritshme për shkak të grumbullimeve masive që kanë ndodhur ditët e fundit. Jo vetëm grumbullimet, por edhe mosrespektimi i këshillave, në lidhje me distancimin fizik, në lidhje me mbajtjen e maskave, në lidhje me shumë elementë të tjerë të kujdesit personal, qoftë edhe të higjienës", ka thënë Bino.

Ajo ka theksuar se kjo rritje e numrave të të infektuarve erdhi si pasojë e lehtësimit të masave shtrënguese të vendosura për afër tre muaj në vend.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Më 19 qershor afati i fundit për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

**Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) u ka bërë thirrje të gjithë zyrtarëve të lartë publikë, që deklarimin e pasurisë ta bëjnë deri më 19 qershor, në të kundërtën për të gjithë zyrtarët që nuk u përgjigjen obligimeve ligjore për deklarimin e pasurisë, AKK-ja do të ndërmarrë veprime ligjore konform mandatit dhe ligjeve në fuqi**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Në pajtim me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/38 të datës 31.05.2020, për lehtësimin e masave pas situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, Agjencia kundër Korrupsionit ka vazhduar afatin e deklarimit të pasurisë deri më 19 qershor.

AKK-ja ka njoftuar se procesi i deklarimit të pasurisë do të bëhet konform nenit 3 të ligjit nr. 04-L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë si dhe nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-228.




"Nga data 1 mars deri tani, nga gjithsej 4694 zyrtarë që kanë për obligim ligjor deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, kërkesës për deklarimin e pasurisë i janë përgjigjur mbi 80 për qind e zyrtarëve të cilët kanë dorëzuar formularët e deklarimit të pasurisë në AKK", ka njoftuar kjo agjenci.

Me këtë rast, Agjencia Kundër Korrupsionit u ka bërë thirrje të gjithë zyrtarëve të lartë publikë që deklarimin e pasurisë ta bëjnë deri më 19 qershor 2020, në të kundërtën për të gjithë zyrtarët që nuk u përgjigjen obligimeve ligjore për deklarimin e pasurisë, AKK-ja do të ndërmarrë veprime ligjore konform mandatit dhe ligjeve në fuqi.

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, ka siguruar se AKK-ja do të jetë në shërbim të të gjitha subjekteve deklaruese për t'i ofruar të gjitha informatat e nevojshme për zyrtarët publikë në mënyrë që procesi i deklarimit të pasurisë të përfundojë me sukses, gjithnjë duke respektuar obligimet e përcaktuara me ligj.

Po ashtu, Agjencia Kundër Korrupsionit ka njoftuar të gjitha subjektet deklaruese se janë të obliguara që ta bëjnë deklarimin e pasurisë me marrjen e detyrës dhe pas largimit/shkarkimit nga funksioni brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e marrjes së detyrës dhe pas largimit/shkarkimit, sipas ligjit në fuqi.

# Shqiptarët dhe serbët në Kosovë e përkrahin një marrëveshje finale me Serbinë




PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Shumica e qytetarëve të Kosovës e përkrahin arritjen e një marrëveshjeje finale midis Kosovës dhe Serbisë, tregon një hulumtim i bërë nga Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA).

Hulumtimi është publikuar të martën dhe ka për bazë 1 107 të anketuar, prej tyre 90 për qind shqiptarë, 8 për qind serbë dhe 2 për qind të komuniteteve të tjera.

Sipas hulumtimit, 92 për qind e shqiptarëve dhe 64 për qind e serbëve thonë se duhet të bëhet çdo përpjekje për arritjen e marrëveshjes finale, ndërsa 66 për qind e shqiptarëve dhe 49 për qind e serbëve e mbështesin rifillimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Ky dialog ka nisur qysh në vitin 2011. Por, procesi është ndërprerë në fund të vitit 2018 për shkak të një takse që ua ka vënë Qeveria e atëhershme e Kosovës prodhimeve të importuara nga Serbia.

Anketa e RIDEA-s është realizuar në 38 komuna të shtatë rajoneve kryesore në Kosovë: Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë - Veri dhe Jug.

# Kosova rihap aeroportin brenda dhjetë ditësh

**Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Arban Abrashi ka theksuar se ka zhvilluar takime me të gjitha institucionet, përfshirë këtu Autoritetin e Aviacionit Civil, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", kompanitë ajrore dhe Ministrinë e Shëndetësisë për rikthimin sa më të shpejtë të fluturimeve.**

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Arban Abrashi, ka thënë se pret që fluturimet në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" të rinisin brenda dhjetë ditësh. Ato janë ndërprerë qysh në muajin mars për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Abrashi ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se ka zhvilluar takime me të gjitha institucionet, përfshirë këtu Autoritetin e Aviacionit Civil, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", kompanitë ajrore dhe Ministrinë e Shëndetësisë për rikthimin sa më të shpejtë të fluturimeve. "Po bëjmë përpjekje që brenda dhjetë ditësh të bëhet rifillimi i plotë i fluturimeve ndërkombëtare, duke respektuar plotësisht udhëzimet për masat e sigurisë për parandalimin e Covid-19 [sëmundjes që e shkakton koronavirusi], të lëshuara nga



Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA) dhe udhëzimet e tjera nga Ministria e Shëndetësisë", ka thënë Abrashi.

Kosova ka regjistruar rastet e para me koronavirus më 13 mars dhe menjëherë ka vendosur masa izolimi, përfshirë mbylljen e kufijve, të shkollave dhe të gastronomisë. Lehtësimi i masave ka nisur të bëhet gradualisht qysh më 4 maj.

Në Kosovë, gjithsej 1 263 raste janë konfirmuar me koronavirus. Prej këtyre, 912 pacientë janë shëruar, ndërsa 31 kanë vdekur.

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

# QEVERIA E RE DO TA KTHEJË K

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, është shprehur i bindur se qeveria e re do ta kthejë Kosovën në binarët e duhur. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se qeverinë Hoti e presin sfida të shumta si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm. Deputeti i AAK-së ka deklaruar se kjo qeveri ka për detyrë t'i rikuperojë raportet me ShBA-në dhe të fillojë me rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës. Sipas tij, në procesin e dialogut me Serbinë, Kosovës i duhet unitet i spektrit institucional dhe politik



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka pritje normale nga qeveria Hoti. Ai ka thënë se qeveria e re do ta kthejë Kosovën në binarët e duhur si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka përmendur sfidat të cilat e presin këtë qeveri, pjesë e së cilës është edhe AAK-ja. "Qeveria e re besoj shumë se Kosovën do ta kthejë në binarët e duhur edhe brendapërbrenda, por edhe në raport me miqtë e shumtë siç janë ShBA-ja dhe vendet e BE-së. Qeveria ku jemi partnerë ne si AAK do të angazhohet dhe do ta ketë edhe mbështetjen tonë si deputet, që ta fillojë rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës, siç është sektori privat, ekonomia familjare me theks të veçantë", ka thënë Lekaj.

Ai ka deklaruar se me partnerët ndërkombëtarë duhet angazhim i të gjithë spektrit politik që të përmbyllet historia e dialogut me Serbinë. Sipas Lekajt, epilogu i këtij procesi do të jetë njohja reciproke mes dy shteteve në kufijtë e shpallur më 17 shkurt 2008. "Krejt çka është e duhur, uniteti i spektrit institucional e politik të Kosovës në raport me këtë proces. Dialogu Kosovë - Serbi duhet të mbyllet me njohje reciproke. Vulën këtij procesi duhet t'ia vë Kuvendi i Kosovës si organi përfaqësues i sovranit popullit të Kosovës", ka thënë Lekaj.

Deputeti i AAK-së ka deklaruar se Kosova nuk duhet të frikësohet nga ky proces. Ai ka folur edhe për opozitën e cila e ka kundërshtuar formimin e qeverisë së re. "Partitë opozitare e kanë detyrë të kritikojnë, prandaj janë opozitë dhe, si të tilla, do ta kenë hapësirën e nevojshme për angazhimin konstruktiv që të suportohen prej anës së tyre temat e interesit nacional. Ne i thërrasim të gjithë që kundërshtimet politike t'i lëmë për zgjedhje e kur është në pyetje vendi ynë përballë temave nga jashtë, të bëhemi zë unik", ka thënë ai.

**"Epoka e re":** *Z. Lekaj, qeveria e re deri më tani ka mbajtur disa mbledhje në të cilat janë marrë edhe shume vendime. Pritjet e juaja nga kjo qeveri?*

**Lekaj:** Qeveria e re besoj shumë se Kosovën do ta kthejë në binarët e duhur edhe brendapërbrenda, por edhe në raport me miqtë e shumtë, siç janë ShBA-ja dhe vendet e BE-së. Qeveria ku jemi partnerë ne si AAK do të angazhohet dhe për këtë do ta ketë edhe mbështetjen tonë si deputetë, që të fillojë rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës, siç është sektori privat, ekonomia familjare me theks të veçantë. Në kontinuitet me partnerët ndërkombëtarë duhet angazhim i të gjithëve që të përmbyllet historia e dialogut me Serbinë, me epilogun e ditur, njohjen reciproke në kufijtë e shpallur më 17 shkurt 2008.

**"Epoka e re":** *Opozita po e kundërshton kete qeveri. LV-ja po e quan qeveri koti, ndersa PDK-ja qeveri te deshtimit. Cili eshte mendimi juaj ndaj ketyre vleresimeve te opozites?*

**Lekaj:** Partitë opozitare e kanë detyrë të kritikojnë, prandaj janë opozitë dhe, si të tilla, do ta kenë hapësirën e nevojshme për angazhimin konstruktiv që të suportohen prej anës së tyre temat e interesit nacional. Ne i thërrasim të gjithë që

## Vetëvendosje kërkon interpelancë pas heqjes së masave të reciprocitetit

PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se të martën ka dërguar në Kuvendin e Kosovës një kërkesë për interpelancë rreth heqjes se masave të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë. "Heqja e masave të reciprocitetit është heqje dorë nga subjektiviteti shtetëror, kurse lejimi nga qeveria e paligjshme dhe jolegjitime e emërtimeve jokushtetuese përkundër se kishte filluar të respektohej emërtimi kushtetues Republika e Kosovës, është zmbrapsje e dëmshme politike dhe tregtare për shtetin e Kosovës", është thënë në njoftimin e LV-së.

Qeveria e kaluar e Kosovës, e drejtuar nga Albin Kurt, pati zëvendësuar taksën 100 për qind ndaj importeve të Serbisë me masë të reciprocitetit.

Mirëpo kryeministri aktual, Avdullah Hoti, ka hequr të gjitha masat ndaj Serbisë, më 6 qershor, për shkak të, siç është shprehur ai, heqjes së të gjitha pengesave për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Ky proces është pezulluar prej vendosjes së taksës nga autoritetet e Kosovës në mallrat serbe në nëntor të vitit 2018.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ka nisur më 2011 në Bruksel.



# OSOVËN NË BINARËT E DUHUR



kundërshtimet politike t'i lëmë për zgjedhje e kur është në pyetje vendi ynë përballë temave nga jashtë, të bëhemi zë unik.

**"Epoka e re":** *Qeveria ka hequr reciprocitetin ndaj Serbisë, vendim i cili eshte kundërshtuar nga AAK-ja. Pse AAK-ja votoi kundër ketij vendimi?*

**Lekaj:** Ne mendojmë se reciprociteti ka ekzistuar edhe më herët se tani, ka qenë proklamim populist i ish-qeverisë, deklarimi i vendosjes së tij, disa ditë pa i lëshuar zyrat e qeverisë dhe çka është me rëndësi, Kosova mbrohet nga Kushtetuta dhe ligjet sovrane të saj në raport me të gjitha shtetet e rajonit. Taksa (brenda të cilës ka qenë edhe reciprociteti) ka hequr nga tavolina diskutimet për mundësinë e lëvizjes së kufijve dhe kjo është më e rëndësishmja tani për tani.

**"Epoka e re":** *Pas heqjes se reciprocitetit, pritet te rifilloje dialogu Kosove - Serbi. Cfare qasje duhet te ndjekë Kosova ne kete proces?*

**Lekaj:** Krejt çka është e duhur, uniteti i spektrit institucional e politik të Kosovës në raport me këtë proces. Dialogu Kosovë - Serbi duhet të mbyllet me njohje reciproke. Vulën këtij procesi duhet t'ia vë Kuvendi i Kosovës si organi përfaqësues i sovranit - popullit të Kosovës.

**"Epoka e re":** *Kjo qeveri po quhet edhe qeveri e dialogut. Sa besoni qe brenda ketij mandati qeverises do te arrihet marreveshja perfundimtare me Serbinë?*

**Lekaj:** Ne duhet të jemi të gatshëm si Kosovë, të jemi pjesë e dialogut, epilogu i të cilit do të duhej të ishte njohja reciproke. Garante për këtë etapë përfundimtare të dialogut duhet të jetë ShBA-ja. Presioni i ShBA-së dhe BE-së duhet drejtuar kah Serbia, që e njëjta t'i ndalë agjendat e këqija në raport me Kosovën.

## Selimi takohet me drejtuesit e agjencive në Ministrinë e Drejtësisë, i siguron për mbështetje

PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, të martën është takuar me drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi dhe Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror, Sami Istrefi.

Gjatë këtyre takimeve, ministri Selimi është njoftuar për punët, objektivat, sfidat dhe proceset që kanë këto dy Agjenci të cilat funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Ministri Selimi është njoftuar nga drejtori i ShKK-së për përparimin e arritur në këtë agjenci që, sipas tij, është me rëndësi të posaçme për një shtet të ri. "Si përkushtim ndaj fuqizimit të sundimit të ligjit jemi të fokusuar në rritjen e efikasitetit të mekanizmave të sistemit juridik, në këtë kontekst edhe në modernizimin e digjitalizimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës", ka thënë Selimi.

Po ashtu, ministri Selimi është takuar edhe me Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror nga i cili është njoftuar për gjendjen, sfidat dhe projeksionet për të ardhmen e Avokaturës Shtetërore. "Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror e sigurova për mbështetjen time, veçanërisht për krijimin e kushteve dinjitoze të punës në këtë agjenci", ka theksuar Selimi.



# AShAK-u kërkon transparencë për dialogun me Serbinë

PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) ka përmbledhur në një botim të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun Kosovë - Serbi. Përmes një komunikate për medie, AShAK-u ka treguar se tashmë ka nxjerrë botimin në uebin zyrtar, në të cilin mund të kenë qasja të gjithë të interesuarit. "Me botimin dhe publikimin e marrëveshjeve Kosovë - Serbi, AShAK synon ta tërheqë vërejtjen se gabimet e deritashme në marrëveshje dhe dialog nuk mund të përsëriten në të ardhmen dhe se dialogu i pritshëm e ka të vetmen bazë në parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. AShAK në të ardhmen do ta monitorojë nga afër procesin e dialogut dhe do t'i diskutojë në tribuna të hapura të gjitha marrëveshjet që do të arrihen me Serbinë, për ta instaluar një kulturë të llogaridhënies, e cila i ka munguar Kosovës dhe demokracisë së saj ende të brishtë dhe të lënduar nga veprime të papërgjegjshme të klasës sonë politike", është thënë në komunikatën e AShAK-ut.

Ky institucion ka kërkuar transparencë në procesin e dialogut Kosovë - Serbi, i cili pritet të rifillojë së shpejti. "AShAK insiston se dialogu



Kosovë - Serbi duhet të jetë i hapur dhe transparent, të mos zhvillohet larg syve të opinionit sepse një njohje e plotë e opinionit me procesin e dialogut dhe me vendimet që merren me këtë rast, ndër të tjera, siguron vendimmarrje të përgjegjshme dhe adreson qartas përgjegjësinë individuale dhe institucionale të pjesëmarrësve të përfshirë në këtë proces, në përputhje me rëndësinë që ka ky dialog për të ardhmen e Republikës së Kosovës", është theksuar në komunikatën e AShAK-ut.

# Hoti: Angazhohemi për marrëveshje që do të rezultonte me njohje të ndërsjellë



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka takuar të martën ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott, të cilit i ka treguar se qeveria e tij është e përkushtuar që të punojë për sundimin e ligjit dhe luftimin e korrupsionit.

Në një komunikatë për media, të lëshuar nga Zyra e Kryeministrisë, është thënë se të dy zyrtarët kanë theksuar se integriteti territorial i Kosovës është i paprekshëm. Sa i përket çështjes së dialogut me Serbinë, kryeministri Hoti ka thënë se dialogu do të zhvillohet duke u bazuar në principe të qarta që burojnë nga Kushtetuta e Kosovës. Sipas tij, Qeveria e Kosovës është e angazhuar për një marrëveshje që do t'i zgjidhte të gjitha çështjet e hapura me Serbinë dhe që do të rezultonte me njohjen e ndërsjellë.

Abbott në anën tjetër është cituar të ketë thënë se Britania e Madhe do të vazhdojë t'i përkrahë institucionet e Kosovës si vende partnere në projekte të përbashkëta, të cilat synojnë zhvillimin e Kosovës, forcimin e demokracisë, sundimin e ligjit, ekonominë dhe meritokracinë në rekrutime.

Kujtojmë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është pezulluar nga nëntori i vitit 2018, kur autoritetet e Kosovës patën vendosur taksë 100 për qind në mallrat e Serbisë dhe Bosnje-Hercegovinës. Kjo masë është zëvendësuar me reciprocitet, mirëpo qeveria e re e kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, ka hequr të gjitha masat për shkak të, siç është shprehur ai, heqjes së të gjitha pengesave për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ka nisur më 2011 në Bruksel.

## Osmani: Luftimi i krimit dhe korrupsionit krijon institucione të besuara e kredibile

PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, të martën ka mbajtur një takim me drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion, Shaip Havolli, si dhe udhëheqësen e UNDP-së, Maria Suokko. Ky takim është realizuar me rastin e fillimit të angazhimit të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit në hartimin e strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2021-2025.

Kryetarja Osmani ka falënderuar për rolin mbështetës që ka UNDP-ja në hartimin e strategjisë. Ajo ka thënë se angazhimi në luftën kundër korrupsionit krijon mundësinë për institucione të besuara dhe kredibile. Në këtë takim, gjithashtu u diskutua edhe për bashkëpunimin dhe bashkërendimin institucional deri në fazën finale të aprovimit të strategjisë nga Kuvendi i Kosovës. Po ashtu, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar të martën edhe ambasadorin britanik në vendin tonë, Nicholas Abbott.

Në këtë takim u diskutua edhe për çështjet e aktualitetit politik, me theks të veçantë me çështjet që ndërlidhen më dialogun dhe rolin e Kuvendit në këtë proces.

Kryetarja Osmani ka riaktualizuar kërkesën dhe nevojën për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe ambasadës britanike. Në këtë kontekst, të dy u pajtuan për rritjen e transparencës dhe meritokracisë në procesin e



rekrutimit të anëtarëve të rinj, në agjencitë dhe ndërmarrjet që janë në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe të institucioneve të tjera në nivel të vendit.

# Komiteti për menaxhimin e Covid-19 diskuton për masat e ndërmarra në Kosovë për menaxhimin e pandemisë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 9 QERSHOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë të martën se në kuadër të zbatimit të planit të punës së qeverisë prioritet kryesor mbetet luftimi i pandemisë Covid-19 krahas objektivave të tjera dhe, në funksion të këtij qëllimi, ai ka kërkuar nga institucionet që t'i vazhdojnë aktivitetet intensive për menaxhimin e situatës, në një kohë kur në shumë shtete përreth, por edhe në Kosovë, po regjistrohen raste të reja të infeksionit nga Covid-19 dhe ka numër të konsideruar të rasteve aktive.

Me qëllim të vlerësimit, koordinimit dhe mbajtjes së komunikimit konstant me institucionet përgjegjëse qeveritare për të vlerësuar situatën epidemiologjike me Covid-19, ministri Zemaj ka kryesuar një takim të Komitetit për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ku, përveç raportimit nga të gjitha institucionet, u kërkua që të vazhdohet zbatimi i aktiviteteve të planit të veprimit të planit të gatishmërisë dhe reagimit ndaj Covid-19, duke adaptuar një qasje të përshtatshme për rrethanat. "Sot jemi në një situatë tjetër, atë të zbatimit të fazës së tretë të hapjes graduale ekonomike, e cila kërkon rivlerësimin edhe të disa veprimtarive të cilat presin për t'u liruar. Kjo fazë, siç edhe është vërejtur, bart në vete rrezikun e përhapjes së mëtejme të virusit, pas një periudhe relativisht pozitive kur rastet me Covid-19 kishin rënë pothuajse në nivelin më të ulët", ka thënë Zemaj.

Ai ka theksuar se rënia e disiplinës në zbatimin e masave në tri ditë e fundit është përkthyer në 105 raste të reja të Covid-19 në Kosovë dhe kjo kërkon nga institucionet monitoruese dhe mbikëqyrëse për zbatimin e masave të Qeverisë (Policia e Kosovës dhe inspektoratet qendrore dhe komunale) që të jenë sa më të pranishme me inspektime në veprimtaritë e lejuara.

Duke theksuar faktin se MSh-ja është në proces të përgatitjes së Manualit me udhëzime për veprimtaritë e lejuara, ai tha se rivlerësimi dhe vendimi për hapjen e veprimtarive të tjera si aeroportet, kufijtë, ahengjet, banjat rehabilituese, panairet, pishinat, klubet e natës etj., duhet të shoqërohet me analiza të bazuara në indikator matës ku kontributin kryesor duhet ta japë IKShPK-në ashtu që secili vendim i marrë të jetë i qëndrueshëm dhe në përputhje me situatën epidemiologjike. "Është shumë e rëndësishme që të mos e lëmë asnjë mekanizëm pa e aktivizuar në funksion të menaxhimit të pandemisë, ushtrimi i përgjegjësive të plotë bazuar në ligje, IKShPK e MAShTI ta bëjnë vlerësimin dyjavor të aktiviteteve të lejuara në fushën e edukimit dhe shkollimit në gjitha nivelet dhe vendimet të merren në koordinim të plotë e të gjitha institucionet, bazuar në rekomandimet e IKShPK-së", ka thënë ministri Zemaj.

Këshilltari për Shëndetësi i kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, Visar Berisha, ka thënë se Zyra e Kryeministrit të Kosovës i jep mbështetje të plotë Komitetit që t'i vazhdojë aktivitetet e tij derisa do ta fuqizojë atë edhe përmes trupave këshillëdhënëse, kurse përmes programit qeverisës është paraparë edhe përkrahja me resurse humane e monitorimit të zbatimit të manualit për veprimtaritë e liruara në kuadër të hapjes ekonomike dhe atyre që do të hapen. Në këtë takim, përfaqësuesit e Komitetit kanë raportuar për aktivitetet e ndërmarra në nivel të institucioneve dhe mekanizmave që përfaqësojnë, derisa kërkohet që qytetarët të vazhdojnë t'i respektojnë masat mbrojtëse si: bartjen e maskave, distancimin fizik dhe mirëmbajtjen e higjienës personale e kolektive.

## Qeveria miratoi propozimet e MSh-së lidhur me Covid-19

Me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar të martën vendimin për shfuqizimin e pikave të vendimit të Qeverisë të datës 31 maj 2020, në të cilat është përcaktuar që: Të gjithë personat që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës dhe kanë në posedim rezultatin negativ të testit për Covid-19, jo më të vjetër se katër ditë, nuk u nënshtrohen procedurave të vetizolimit; Ata që nuk kanë testin, detyrohen të vetizolohen për shtatë ditë; Qytetarët që manifestojnë shenja klinike udhëzohen nga profesionistët shëndetësorë në pikat kufitare; dhe deri më 20 qershor do të bëhet rivlerësimi i situatës epidemiologjike dhe me këtë do të reflektohen masa të reja lidhur me pikat kufitare dhe hyrjen e qytetarëve në Republikën e Kosovës. "Mbetet në fuqi pika e vendimit sipas së cilës është përcaktuar që të gjithë personat që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, obligohen t'u nënshtrohen kontrolleve të ekipeve mjekësore të QKMF-ve (qendrave kryesore të mjekësisë familjare) në pikat kufitare dhe t'i zbatojnë masat mbrojtëse kundër Covid-19. Deri më 12 qershor 2020 Ministria e Shëndetësisë miraton Manualin për Mbrojtje nga përhapja e virusit Covid-19, ku specifikohen të gjitha detajet për mënyrën e organizimit të punës në të gjitha bizneset private, ndërmarrjet publike, në institucionet publike dhe çdo veprimtari tjetër. Autorizohet Ministria e Shëndetësisë që në pajtim me Ligjin t'i nisë procedurat e rekrutimit të dyqind specialistëve shëndetësorë që do ta mbikëqyrin zbatimin e manualit nga ky vendim", është bërë me dije në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.



## Kryeministri Hoti zotohet për trajtim dinjitoz të kategorive të dala nga lufta

PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Kryeministri Avdullah Hoti ka pritur të martën në takim kryetarin e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, me bashkëpunëtorë. Sipas njoftimit të qeverisë, kryeministri Hoti gjatë këtij takimi theksoi përkushtimin e qeverisë për thellimin e bashkëpunimit me Organizatën e Veteranëve të Luftës Çlirimtare duke u zotuar për trajtim dinjitoz të kategorive të dala nga lufta. Ndërsa kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, ndër të tjera, shprehu vullnetin e tij për bashkëpunim të mëtejmë me qëllim të avancimit të gjendjes dhe mirëqenies së veteranëve të UÇK-së.

# Kosova e përçarë për hapjen e bisedimeve me Serbinë dhe thelbin e marrëveshjes përfundimtare



Prof. Lisen BASHKURTI

Kosova po përjeton një situatë të vështirë politike, diplomatike, institucionale, ekonomike dhe sociale kohët e fundit. Madje, edhe mbas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të fund-majit 2020 për krijimin e qeverisë Hoti, vendi duket se po rifutet në një cikël të ri krize shumë më komplekse. Epiqendra e krizës është hapja e dialogut Kosovë - Serbi për arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve. Palët politike në Kosovë kanë qasje të ndryshme për hapjen e negociatave. Në parim të gjithë në Kosovë janë pro negociatave, si rruga më e mirë për zgjidhjen e problemeve me Serbinë. Polemika politike në Kosovë është e lidhur, së pari me procedurat e hapjes së këtyre negociatave, së dyti, me përmbajtjen e tyre, së treti, me ndërmjetësuesit ndërkombëtar dhe, së katërti, me shpejtësinë e realizimit të marrëveshjes. Me dy të parat do të merremi në këtë shkrim. Me dy të dytat do të merremi me një shkrim tjetër pasues.

## 1. Procedura e hapjes së bisedimeve

Në bisedimet, dialogun dhe negociatat diplomatike procedurat kanë rëndësi të veçantë. Lidhur me procedurën për hapjen e negociatave, tri qeveritë e fundit në Kosovë kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për hapjen e negociatave, krahasuar me qeveritë e mëparshme. Qeveria e AAK-së me kryeministrin Haradinaj aplikoi tarifën 100 për qind të mallrave serbe si kundërreagim për hapjen e negociatave. Kjo bllokoi procedurën e hapjes së negociatave. Qeveria e LV-së me kryeministrin Kurti hoqi tarifën e qeverisë Haradinaj dhe vendosi masën e reciprocitetit, edhe kjo sërish si reagim për hapjen e negociatave. Edhe kjo masë vijoi t'i mbante të bllokuara procedurën e hapjes së negociatave me Serbinë. Qeveria e LDK-së me kryeministrin Hoti po ndjek qasjen e heqjes së të gjitha barrierave të të dy qeverive paraardhëse, si të tarifës së z. Haradinaj, ashtu edhe atë të reciprocitetit, të z. Kurti, me qëllim procedimin për hapjen e negociatave me Serbinë. Shkak i kësaj inkoherence dhe përplasjeje qeveritare në Kosovë është presidenti Thaçi, cili që në krye të herës ka insistuar për heqjen në mënyrë të pakushtëzuar të çdo barriere që, sipas qasjes së tij dhe të Serbisë, por jo vetëm, pengon hapjen e negociatave. Tani Kosova i ka hequr të gjitha të ashtuquajturat pengesa për hapjen e dialogut me Serbinë ose, më saktë, u është nënshtruar kushteve të Serbisë. Është koha ta presim reagimin e Beogradit, i cili ka zgjedhjet politike të 21 qershorit 2020. Pra, gjithçka do të ngelet për më vonë. Zgjedhjet, konstituimi i organeve të reja postzgjedhore, përballimi i Covid-19 dhe i verës së nxehtë, pajtimi me ndërmjetësuesit ndërkombëtarë dhe më tej hapja e negociatave me Kosovën, duket se do të jetë sërish Beogradi që do të vendosë për kohën e hapjes së negociatave, pa kurrfarë pajtimi me Kosovën. Kosova duhet të jetë gati me draft-agjendën, strategjinë, parimet bazë, prioritetet, taktikat negociuese, skenarët e mundshëm, ekipin negociator, ekipet e ekspertëve mbështetës, ndarjen e roleve brenda ekipit, mandatimin e liderit dhe opsionet finale më të pranueshme të marrëveshjes. Një pjesë e këtyre elementëve duhet të miratohen në Kuvendin e Kosovës, maksimalisht me konsensus, minimalisht me një bazë sa më të gjerë politike. Pjesa tjetër i ngelet ekipit negociator për t'i vendosur konfidencialisht dhe në proces e sipër.

## 2. Thelbi i përmbajtjes së bisedimeve

Në bisedime, dialog dhe negociata diplomatike përmbajtja është çështja themelore. Lidhur me përmbajtjen e negociatave polemika politike në Kosovë është edhe më e thellë, përçarja edhe më e madhe. Në epiqendër të polemikës dhe përçarjes qëndron qasja ndaj cenimit të territorialitetit të Shtetit të Kosovës në dobi të Serbisë. Edhe këtë aspekt të krizës brenda Kosovës përgjegjës kryesor është presidenti Thaçi. Ish-kryeministri Thaçi, që kaloi më pas në pozitën e presidentit, përgjatë bisedimeve lejoi devijime të shumta proceduariale dhe përmbajtjesore. Thaçi tejkaloi karakterin teknik të bisedimeve dhe hyri pa mandat në çështje politike; negocioi për aspekte të panegociueshme konstitucionalisht, siç është pacënueshmëria e territorialitetit të Kosovës; nuk bëri raportim dhe transparencë si autoritet negocius përpara Kuvendit të Kosovës; zhvilloi bisedimeve personale sekrete me palën serbe, si dhe transferoi autoritetin kryesor negocius të palës kosovare, nga qeveria të cilën e ngarkon Kushtetuta dhe Rezoluta e Kuvendit e vitit 2012, te presidenti, pra te vetvetja, që nuk ka autoritet kushtetues dhe as mandat parlamentar për kryesimin e negociatave në emër të Kosovës. Këto devijime nga Kushtetuta dhe rezoluta e vitit 2012 të Kuvendit të Kosovës janë përgjegjësi e presidentit Thaçi, i cili është bërë objekt kryesor i polemikave në Kosovë.
Polemikat polarizuan politikën dhe institucionet sollën ndryshime qeveritare të njëpasnjëshme dhe bllokuan nga viti 2018 bisedimet formale me Serbinë.
Është presidenti Thaçi i cili gjatë bisedimeve sekrete personale me Serbinë, pa autoritet kushtetues dhe pa mandat të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës të vitit 2012, negocioi integritetin territorial i Kosovës.
Presidenti Thaçi duket se ka pranuar versionin serb të presidentit Vuçiq, në bashkëpunim edhe me kryeministrin e Shqipërisë, z. Rama, për 'shkëmbimin territorial', i cili në thelb ka të bëjë me copëtimin e Kosovës. Presidenti Thaçi është përpjekur dhe përpiqet që t'i paraqesë 'shkëmbimet territoriale' si çështje 'shkëmbimesh reciproke' midis Kosovës dhe Serbisë.
Në fakt, nuk është kështu. Plani Vuçiq-Thaçi-Rama i heq Kosovës rreth 15 për qind të territorit të saj dhe kjo, e konvertuar në tregues ekonomik, është afro 25 për qind e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto të Kosovës. Këtu kihet parasysh se territoret e parapara për t'i kaluar Serbisë janë më të pasurat me lëndë të para, burime ujore dhe vlera natyrore. Me këto lëshime territoriale dhe ekonomike Kosova rrezikon të humbasë ekulibrin e viabilitetit mbijetues ekonomik dhe të shndërrohet në një ekonomi me profil fermë agro-blegtorale. Një Kosovë e copëtuar dhe e varfër është lehtësisht e thyeshme dhe e nënshtrueshme dhe, si e tillë, ka qenë dhe mbetet strategji e Serbisë.
Ky opsion serb, i pëlqyer nga presidenti Thaçi, është kundërshtuar nga shumica dërrmuese e faktorit politik në Kosovë, si LV-ja, LDK-ja, AAK-ja, Nisma, nga opinioni publik, media, shoqëria civile, akademikët si dhe faktorë të fuqishëm ndërkombëtarë si BE, Gjermani, Francë, Britani, vendet e Ballkanit Perëndimor, fqinjët rreth Kosovës e Serbisë si dhe personalitete të shquara të diplomacisë shqiptare, evropiane dhe amerikane.
Projekti Vuçiq-Thaçi-Rama, me ndikues të tjerë gjeopolitikë dhe diplomatikë, mbas tyre thuhet të jetë varrosur. Por, unë nuk mendoj kështu. Ideja e këtij plani është sërish gjallë. Sa kohë ideja është gjallë, rreziku mbetet i lartë për Kosovën, sikundër edhe për paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe në Evropë.

# Likaj: SBAShK-u do të jetë pjesë e proceseve në krijimin e politikave zhvillimore të arsimit

PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka pritur të martën në takim kryetarin e SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj dhe koordinatorin për organizim të brendshëm të kësaj Sindikate, Ymer Ymeri, me të cilët ka biseduar për bashkëpunimin në mes të Ministrisë dhe Sindikatës në të mirë të zhvillimit të arsimit në vend.
Ministri Likaj shprehu gatishmërinë për të punuar ngushtë me SBAShK-un dhe theksoi se kjo Sindikatë do të jetë pjesë e proceseve në krijimin e politikave zhvillimore të arsimit dhe në zbatimin e tyre. Ndërkaq, udhëheqësit e SBAShK-ut i uruan ministrit Likaj detyrën dhe e falënderuan për gatishmërinë për bashkëpunim. Po ashtu, u shprehën të gatshëm ta japin kontributin e tyre si Sindikatë në të mirë të ngritjes së cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit.



# Pandemia Covid-19 rreth 700 mijë udhëtarëve ua pamundësoi fluturimet

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Zëdhënësja e Aeroportit të Prishtinës "Adem Jashari", Valentina Gara, ka bërë me dije se si pasojë e pandemisë Covid-19 rreth 700 mijë udhëtarëve u është pamundësuar fluturimi. Në një konference për media, Gara ka thënë se Aeroporti i Prishtinës "Adem Jashari" ka pasur humbje si pasojë e pandemisë Covid-19 por, pavarësisht kësaj, ajo ka thënë se të gjithë punonjësit kanë marrë pagat. "Siç e dini, prioriteti ynë është siguria, prandaj edhe në bazë të rekomandimeve të Agjencisë së Aviacionit kemi përgatitur udhëzimet sa i përket procesimit të udhëtarëve dhe fluturimeve. Deri më tani kemi pasur një ndikim në numër të udhëtarëve ku rreth 700 mijë udhëtarëve iu është pamundësuar që të procedojnë apo kryejnë fluturimet e tyre gjë që ka ndikuar, po ashtu, në numrin e fluturimeve, jo vetëm të udhëtarëve. Siç e dini, nga virusi Covid-19 të gjitha industritë kanë pësuar apo kanë pasur ndikime negative në operimet e tyre", ka deklaruar Gara.
Ajo ka folur edhe për mënyrën e operimit gjatë kohës së pandemisë. "Ne si Aeroport kemi qenë gjithmonë të hapur edhe gjatë pandemisë, por për shkak të vendimeve të fundit të Qeverisë së Kosovës ka pasur shumë pak patëm realizime të fluturimeve gjatë kësaj kohe. 'Eurowings', 'Swissinternacional' dhe kompani të tjera kanë shprehur interesim që t'i fillojnë linjat nga muaji korrik, në rast se do të kemi një vendim të shpejtë për hapjen e flurimeve edhe për arritjen e udhëtarëve atëherë do të nisin fluturimet. Në kuadër të masave kemi dezinfektuar objektet, automjetet dhe hapësirat që shfrytëzohen nga




# Instituti GAP: Gratë që kërkojnë punë në Kosovë kanë përgatitje më të lartë universitare sesa burrat

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Gjatë këtij viti në Kosovë në kërkim të punës janë regjistruar rreth 38 mijë qytetarë, ku 60 për qind e tyre janë të pashkolluar. Instituti për Studime të Avancuara GAP, përmes raportit "Ndikimi i pandemisë Covid-19 në tregun e punës", ka bërë me dije se vetëm 4 për qind e personave që kërkojnë punë janë me arsim të lartë. Sipas GAP-it, shumica e punëkërkuesve të pashkolluar, me arsim fillor dhe të mesëm janë burra, ndërsa me pjesa tjetër me bachelor, master apo PhD janë gra. "Sa i përket arsimit të punëkërkueseve, pjesa dërrmuese apo 60 për qind e këtyre punëkërkuesve janë të pashkolluar, ndërsa 29




për qind kanë përfunduar shkollën fillore dhe të mesmen profesionale. Rreth 7 për qind janë me gjimnaz të përfunduar, ndërsa 4 për qind me arsim të lartë. Prej punëkërkuesve të pashkolluar, me arsim fillor dhe të mesëm shumica janë burra, përveç punëkërkuesve me Bachelor, Master apo PhD të cilat janë gra. Dallimet në mes të burrave dhe grave në nivel të arsimit lë të kuptohet që edhe tek individët që kanë arsim të lartë do të ketë më shumë gra sesa burra të papunësuar. Kjo mund të vijë si pasojë e kritereve të larta që hasin gratë gjatë kërkimit të një pune qoftë të përshtatshme apo të papërshtatshme me fushën e saj të arsimit, gjë që mund të çojë në një mospërputhje mes atyre dhe një pjesëmarrje më të ulët të grave në treg të punës në përgjithësi", thuhet në raportin e GAP-it.
Sipas këtij raporti, vetëm gjatë prillit të këtij viti në Kosovë listës së punëkërkuesve të Agjencisë së Punësimit bashkë me 34 zyrat e saj lokale i janë shtuar 32 377 punëkërkues të rinj. "Të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës tregojnë se industritë të cilat punësojnë më së shumti punëtorë në Kosovë - ajo e tregtisë me shumicë e pakicë, ndërtimtarisë dhe industrisë përpunuese, shënuan rënie të madhe të punëtorëve gjatë periudhës janar-mars 2020. Përderisa në mars të vitit 2019 në industrinë e tregtisë me shumicë e pakicë punonin rreth 80 mijë persona, në mars 2020 ky numër ra në rreth 43 mijë. Edhe numri i kontributpaguesve në Fondin Pensional të Kosovës (Trust) ka shënuar ulje prej 20 përqindësh në shumicën e komunave të Kosovës", thuhet në këtë raport.
GAP-i më tutje ka analizuar se me gjithë lehtësimin e masave kufizuese dhe hapjen graduale të veprimtarive biznesore, raporti vjen në përfundim se tregu i punës nuk mund të kthehet menjëherë në situatën e para-pandemisë.

# ATK-ja gjatë muajit maj mbledh 4.5 milionë euro më shumë

ATK-ja ka bërë me dije se totali i inkasimit të të hyrave për periudhën janar-maj 2020 është 186.1 milionë euro, ndërsa vetëm për muajin maj inkasimi i të hyrave në raport me planin është për 4.5 milionë euro apo 13 për qind më shumë

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Pas rënies së të hyrave gjatë muajit mars dhe prill si pasojë e pandemisë Covid-19 në Kosovë, në muajin maj ka rikthim të trendit rritës të të hyrave tatimore. Kështu ka bërë me dije Administrata Tatimore e Kosovës. "Inkasimi i të hyrave nga fillimi i këtij viti deri më 18 mars ka qenë në përputhje me planifikimet e parapara, por pas kësaj date është vërejtur një trend i uljes së të të hyrave, duke pasur parasysh efektet e Covid-19 dhe vendimet për shtyrje të afatit të pagesës së detyrimeve tatimore dhe kontribute pensionale", është thënë në njoftimin e ATK-së.
ATK-ja ka bërë me dije se totali i inkasimit të të hyrave për periudhën janar-maj 2020 është 186.1 milionë euro, ndërsa vetëm për muajin maj inkasimi i të hyrave në raport me planin është për 4.5 milionë euro apo 13 për qind më shumë. "ATK nga data 12 mars, pas vendimit të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, ka ndihmuar Qeverinë e Kosovës me masat për parandalim të koronavirusit, duke pranuar denoncime nga qytetarët dhe kryerje të inspektimeve të bizneset, të cilat kanë keqpërdoruar situatën e krijuar nga Covid-19, për t'i rritur




çmimet e artikujve bazikë ushqimorë dhe shëndetësorë, andaj në mënyrë që të zbatohet në përpikëri ky vendim, ATK ka ulur në minimum aktivitetet e rregullta sipas Planit të Punës për 2020", theksohet në njoftimin e ATK-së.

## Komuna e Prishtinës nënshkruan marrëveshjen për projektin e trajtimit të ujërave të zeza



PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti dhe ambasadorja e Republikës së Francës në Kosovë, Marie-Christine Butel, kanë nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Prishtinë.
Projekti ka vlerë prej 66 milionë eurosh. Qeveria e Republikës së Kosovës do të kontribuojë me 20 milionë euro shtesë në projekt dhe do të implementohet deri në vitin 2025, në faza të ndryshme.
Përveç Prishtinës, projekti mbulon edhe trajtimin e ujërave të zeza në komunat Obiliq, Fushë-Kosovë, potencialisht edhe në Graçanicë dhe është rezultat i studimit të fizibilitetit nga viti 2012.

# Përurohet objekti i ri i shkollës në Lladrovc



MALISHEVË, 9 QERSHOR (ER) - Në prag të shënimit të 16 Qershorit - Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Malishevës dhe një ditë para fillimit të procesit mësimor për klasat e nënta, është hapur edhe një objekt i ri shkollor në Komunën e Malishevës.
Nga e marta nxënësit e Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Afrim Buçaj" në Lladrovc do të mësojnë në objekt të ri shkollor dhe në kushte moderne të mësimit.
Ndonëse për shkak të situatës me pandemi u organizua një ceremoni e thjeshtë e përurimit, në këtë ceremoni morën pjesë familje të dëshmorëve nga fshati Lladrovc, kryetari i komunës së Malishevës, Ragip Begaj, nënkryetari Hajdin Berisha, drejtori i DAE, Blerim Thaçi, qytetarë të Lladrovcit, mësues dhe nxënës të kësaj shkolle. "Ne sot po përurojmë edhe një objekt të ri shkollor, në një fshat me traditë të hershme në arsimin shqip. Ju keni dhënë shumë kuadro nga kjo shkollë dhe jam shumë i kënaqur që sot po bëjmë përurimin e kësaj shkolle, duke kërkuar në të njëjtën kohë nga ju mësimdhënës që të punoni shumë për rritjen e cilësisë në arsim, pasi me cilësi të arsimit rritet zhvillimi dhe kështu zhvillohet edhe vendi, prandaj punoni për zhvillim, ndërsa ne do të vazhdojmë me investime në arsimin e komunës sonë. Kontributi më i madh, për të gjitha këto që ne sot po bëjmë, është i dëshmorëve të kombit, prandaj jepni maksimumin tuaj për rritjen e cilësisë në arsim", ka thënë kryetari Begaj.
Ndërtimi i objektit të Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Afrim Buçaj" në Lladrovc u bë nga buxheti komunal i Malishevës. Shkolla ka 13 dhoma mësimi, bibliotekën, sallën dhe 249 nxënës.

# Shkolla e muzikës nga shtatori edhe në Kamenicë



KAMENICË, 9 QERSHOR (ER) - Komuna e Kamenicës është pajtuar në parim për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me komunën e Gjilanit që dega e "Shkollës së Muzikës" në Gjilan të hapet dhe të funksionojë në Kamenicë.
Ushtruesja e detyrës së drejtoreshës e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Mirhane Morina-Bislimi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Arianit Ibrahimi, kanë pritur në takim drejtorin e Drejtorisë së Arsimit në Gjilan, Nazim Gagica dhe drejtorin e Shkollës së Muzikës në Gjilan, Kushtrim Jakupi.
Kryetari i komunës, Qëndron Kastrati, tha se është i lumtur që nxënësit të cilët dëshirojnë ta ndjekin shkollën e muzikës së shpejti do ta kenë këtë mundësi ta bëjnë edhe në Kamenicë. "Nga shtatori do të hapet dega e Shkollës së Muzikës në komunën tonë dhe të gjithë nxënësit nga Kamenica mësimin do ta vijojnë këtu. Pos kësaj, regjistrimet e reja të nxënësve në drejtimin për muzikë do të bëhen në degën që do të hapet në Kamenicë. I lumtur që nxënësve tanë po u ofrojmë mundësi të tilla duke marrë parasysh shpenzimet e secilës familje për t'i dërguar fëmijët në Gjilan", ka thënë ai.
U. d. e DKA-së, Mirhane Morina-Bislimi, ka theksuar se pasi të nënshkruhet ky memorandum bashkëpunimi, nxënësit e Kamenicës nga shtatori do të mund t'i ndjekin mësimet e muzikës në Kamenicë. "Ky memorandum bashkëpunimi, për shkak të specifikave ekonomike-sociale, do t'u mundësojë nxënësve të komunës sonë t'i ndjekin mësimet në shkollën e muzikës më afër. Kjo është një gjë e mirë për ne sepse po punohet për të ardhmen e të rinjve tanë", tha ajo. Kurse drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Arianit Ibrahimi, tha se me hapjen e saj talenti i nxënësve për muzikë do të zhvillohet më shumë.

## Qirezi bëhet me objekt të ri shkollor



Skenderaj, 9 qershor (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin, Nuredin Lushtaku, drejtorin e Arsimit, Bekim Latifi, drejtorë komunalë, asamblistin Ilir Ejupi si dhe me bashkëpunëtorë të tjerë, kanë përuruar objektin e ri të Shkollës Fillore "Dëshmorët e Qyqavicës" në fshatin Qirez. "Me këtë rast i urova nxënësit dhe arsimtarët për shkollën e re duke kërkuar nga ta përkushtim për ruajtjen e hapësirave shkollore si dhe përkushtim edhe më të madh në procesin e edukimit të mirëfilltë të gjeneratave të reja. Mbetemi të përkushtuar për krijimin e kushteve të favorshme për mësim dhe edukim", ka shkruar kryetari Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (2)

# Tri ditë luftë dhe tri net gjëmime



Bedri ISLAMI

Aty unë takova për herë të parë të mbijetuarit. Një rastësi fatlume kishte bërë që një ditë para luftës, disa nga fëmijët të shkonin te dajat e tyre, nga të cilët Jasharët kishin marrë dy bija. I shikoja i habitur dhe nuk më besohej se ata të mbijetuar, shumë nga të cilët ende fëmijë, që kishin kaluar përmes ferrit të luftës dhe përgjakimit të tmerrshëm dhe ishin përsëri aty, tepër të brishtë, njerëzorë. Njëra prej tyre ishte Besarta, 12 vjeçe. Varur paksa në krahun e vëllait të saj, Bekimit, me shikimin e çiltër, përmes të cilit mund të shikoje se si kishin trashëguar brezat mirësinë dhe qëndresën.

Kur mirësia dhe qëndresa vëreheshin tek ajo vajzë, mund të them ende fëmijë, çfarë do të kishte qenë me prindërit dhe të afërmit e saj...

Përpiqesha ta merrja me mend, por nuk mundja. Megjithëse mendoja se i kisha njohur mirë Jasharët, të mbijetuarit, që rrinin të heshtur në dhomën e miqve, krejtësisht të qetë dhe që herë pas here flisnin diçka me zërin e tyre që i gurgullonte, më thoshte se nuk kisha njohur veçse shumë pak.

Edhe sot, pas kaq shumë viteve, ende më tingëllojnë zërat e të mbijetuarve në Kosovë, të cilët, stoikë deri në skaj, të qetë deri në mbijetesë, kishin kaluar përmes provës së zjarrit dhe shpirti nuk u ishte djegur.

Gjithçka ishte e frikshme rreth tyre, por nuk kishin pasur frikë.

Kishte tri ditë dhe dy net që shtëpitë e Familjes, dhe të gjithë lagjes përreth, bombardoheshin pa pushim. Rrënojat e kullave ishin shpërndarë aty këtu dhe përmes tyre ngriheshin flakët e zjarrit. Njëra prej tyre ishte çarë në dysh, në tjetrën ishte hapur një vrimë e madhe, më shumë se dy metra, ndërsa nga ajo që ishte krejt në skaj, kishte filluar të shembej çatia e gjithë. Tjegullat e kuqe ishin stërpikur nga gjaku dhe gurët e themeleve ishin shndërruar në të bronztë. Kishte pasur vetëm një heshtje të vogël në mbarimin e ditës së parë dhe fillimin e natës, pastaj asgjë nuk kishte heshtur më. Vajza e vogël, e brishtë në trup dhe që nuk kishte ende të 11 vitet, ishte strukur nën magjen e shtëpisë, nuk kishte asnjë lloj frike në sytë e saj, priste deri në fund të dëgjonte ndonjërin nga njerëzit e shtëpisë, në se po vazhdonte të këndonte,ose atë këngën e Çerçiz Topullit, ose të Zhujë Selmanit apo "në Dardani bie një tupan" dhe kur, pas heshtjes disi të gjatë, nuk dëgjoi asgjë, diçka i lëvizi në kraharorin e saj. Në tri ditë e dy net ajo kishte parë më shumë se sa shohin burrat shekullarë në një jetë të tërë, dhe tani dëgjonte trarët e shtëpisë kah rrëzoheshin gjysmë të djegur ose zhurmën e mureve kah binin njëri pas tjetrit.

Mbylli sytë dhe deshi të kujtonte të gjithë atë që kishte ngjarë, por nuk mundi, e kishte të vështirë, ndoshta nuk ishte as çasti i duhur, megjithatë bëri edhe një përpjekje të fundit dhe iu duk se gjithçka, në një moment të vetëm, kaloi përbri saj, vizion që nuk mund të kapej, diçka fluide, e dhimbshme deri në skajin ku është e vështirë të mbajë edhe një njeri prej guri. Megjithatë, ajo po mbahej, kishte në të gjithë qenien e saj një shtjellim të vrullshëm ndjenjash, të cilat, ashtu si ishte, nën magjen e shtëpisë, ku po priste,ose të fillonin këngët ose të rifillonte lufta, "vetëm të jetë njëra prej tyre" mendoi, nuk dinte me se t'i bënte bashkë. Të fundmin nga njerëzit e saj kishte parë Kushtrimin, ai ishte vetëm dy vite më i madh se ajo, djali i mixhës së saj, e kishte parë tek vraponte përmes oborrit të shtëpisë me një automatik në dorë, dhe i ishte dukur, se pikërisht në mesin e dy shtëpive, ishte vrarë edhe ai.

Në dhomën ku mysafirët shtoheshin vazhdimisht nganjëherë binte heshtja. Heshtja që po vinte po i rëndonte përherë e më tepër. Në më shumë se 60 orët e fundit çastet e heshtjes kishin qenë të pakta, krejt të pakta, kishte pasur momente kur edhe i kishin dëshiruar ato çaste, sepse kishte qenë e pamundur të përballoje gjithë zhurmën rrokopujëse të tankeve, bombave, granatave, mitralozëve, pastaj ushtimat që vinin nga qielli, tymin e flakët, krismat, të gjithëkundshme, të paprashme. Kishte qenë tepër e vështirë të përballoje tërë furinë e asaj zhurme që mund të çmendte këdo, veç atyre që ishin brenda tri shtëpive të Familjes dhe njerëzve të lagjes së tyre.

Tashmë, kur po fillonte të binte heshtja, në fundin e paradites së ditës së tretë, njerëzit nuk e donin më këtë. Prisnin të ndodhte diçka, të rifillonin krismat, kjo do të ishte një shenjë jete, ose të rifillonte kënga, edhe kjo do të ishte shenjë jete, sepse burrat, aq kohë sa kishin luftuar, po aq kohë edhe kishin kënduar; e nëse ndodhte kështu, kjo do të thoshte se nuk kishte mbaruar çdo gjë, se do të kishte rikthim lufte nën atë muranë të jashtëzakonshme. Mirëpo asgjë nuk po ndodhte. Megjithëse ishin vetëm disa minuta, njerëzve iu dukën sikur kishte një jetë, dhe nuk e donin këtë.

Pas heshtjes që kishte rënë mbi Prekaz, në lagjen e Jasharëve, njerëzve u kishte ngrirë zemra. Çfarë kishte ndodhur? Tri ditë luftë dhe tri net gjëmime. Të kishte qenë fundi i gjithçkaje apo përtej asaj që po ndodhte do të kishte një fillim të ri?

Gjithçka ishte e pabesueshme në atë vorbull shkatërrimi dhe përgjakje, mbi Drenicën kishte rënë pluhuri i luftës, sytë e njerëzve ishin ende të skuqur nga tymrat dhe gazi lotsjellës, bota u duk sikur ndal dhe kur trupat serbe filluan të largoheshin, disa u afruan të parët, me ankthin e padurueshëm në zemër. Ata shikuan rreth vetes dhe dalluan trupat pranë . Një këtu, një aty. kujtuan çastin tragjik, kur një bombë e madhe i kishte rënë bodrumit dhe e kishte ndarë atë përgjysmë, duke e shkatërruar krejtësisht. Aty ishin vrarë disa nga pjesëtarët e familjes së madhe. Kishte qenë një shpërthim i jashtëzakonshëm, fuqia e tij e kishte hedhur nënëzonjën e mirë nga vendi ku ishin, në një dhomë tjetër, sepse ishin shkatërruar edhe muret që ndanin vendin ku ishin strehuar me dhomat e tjera përdhese. Pastaj do të mësonin se sa ishte lufta, kishin dëgjuar në çastet e heshtjes së armëve zërat e burrave dhe djemve të shtëpisë, megjithëse nuk i shihnin dot, pastaj kishin përfytyruar sikur përsëri nëpër shkallët e shtëpive dëgjoheshin hapat e Shaban Jasharit, Hamzës dhe Ademit, ashtu si i kishin njohur, burrërorë dhe fisnikë.

Bënë me kujdes para. Ndjehej era e barotit dhe e pushkëve përzier me erën e zjarrit. Mjekja Teuta Hadri që kishte qenë ndër të parët e gjendur aty e që më pas do të denonconte krimin në mediat ndërkombëtare, iu afrua trupit të parë, që kishte më pranë vetes, e preku lehtë me dorë, pastaj i preku flokët, faqet, e tundi pak shpatullash, i mori kokën në duart e saj, i foli në emër dhe priti se mos do të kishte përgjigje. I thërriste përsëri në emër, por përgjigje nuk kishte. Atëherë ia ulte kokën ngadalë, përpiqej të gjente një vend të sheshtë për pushimin e tyre, afrohej tek tjetri dhe përsëri e prekte lehtas me dorë, i fliste përsëri në emër, priste një përgjigje të shkurtër, një shenjë jete, por përgjigje nuk kishte. Krimi ishte kudo , ashtu si kishte qenë edhe qëndresa.

Përmes pluhurit dalloi dy vajzat që ishin pranë njëra-tjetrës, Hidajeten, vajza e vëllait të madh të familjes, Rifatit, dhe bri saj, Fatimen, vajzën më të vogël të Hamzës. Deshi t'u fliste, ishin gjaku i saj, por pastaj iu kujtua se nga granatimet ata ishin plagosur rëndë. Të dyja ishin mbështetur tek njëra tjetra dhe kishin heshtur. Sidoqoftë ajo u foli edhe një herë, priti me ankth një përgjigje, por përgjigje nuk kishte.

U foli të gjithëve me emër, njëri pas tjetrit, njëzet herë me radhë, njëzet herë priti prej të gjithëve një përgjigje, por heshtje. pastaj , kur nuk po e dinte se çfarë mund të bënte më tej shikoi njerëzit e shumtë që kishin ardhur dhe hangari i gjatë ishte zbardhur nga mbulesat mbi të rënët. Gjithçka ishte mbyllur, për të rinisur. Ishte fundi i paradites së shtatë marsit 1998. Kishte tri ditë e dy net që luftohej.

Gjithçka përreth ishte përskuqur ose djegur e zhuritur. Erërat e atij fillim marsi ishin tej e për tej të mbushura me erën e veçantë të barotit, dhe duke lëvizur drejt fillimit të bjeshkëve, dukej sikur merrnin me vete pjesët e luftës.

Mjekja e shquar do të kujtonte më pas se çfarë kishte ndodhur dhe kishte shkruar në Ditarin e saj të luftës, "Krimi që pashë me sytë e mi", dëshminë më të saktë të luftës, ku ajo vetë kishte qenë pjesë. Do të jetë Ditari më rrëqethës, që pa asnjë droje ka dimensionet e një Ditari të njohur , si ai i Ana Frankut, por që autore do të kishte një grua pjesë e lëvizjes klandestine dhe nga një familje e shquar atdhetarësh e mentarësh, çka e bënte edhe më të besueshme dëshminë e saj.

Ajo do të dëshmonte më pas se , e mbijetuara e parë, vajza e vogël, në çastet e një përmase homerike, nuk dallonte thuajse asgjë më, kur befas, krejt befas, ajo dëgjoi zhurmën e krismave të plumbave që përplaseshin nëpër gurët e shtëpisë, rafalë të një pas njëshme, një tym i dendur pastaj mbuloi gjithçka dhe ajo e diti mirëfilli se nuk ishin njerëzit e saj që po qëllonin. Sepse ata nuk mund të qëllonin kurrë mbi themelet e tyre. Askush nga Fisi i tyre nuk e kishte bërë këtë dhe vajza e vogël kishte kohë, shumë kohë që e kishte mësuar këtë. Ajo priti se çfarë mund të ndodhte. Nuk ndjente asnjë lloj frike, nuk kishte të dridhura dhe as që kishte kohë të mendohej se çfarë mund të ndodhte. Sido që të ishte, asgjë nuk do të mund të ishte më e rëndë se sa ajo që kishte ndodhur. Pas heshtjes së krismave në fillim ishin dyndur kriminelët e çartur. Të çarturit futeshin brenda nëpër rrënojat e dhomave dhe qëllonin, pastaj, gjithë frikë u afroheshin të rënëve duke pasur drojën e rizgjimit, u dukej çudi që në asnjë fytyrë nuk dukej frika, ata, të gjithë, ishin të qetë edhe pasi i kishin vrarë, aq të qetë sa të dukej sikur mund të ringriheshin dhe kjo ishte gjëja që kishin pasur më shumë frikë. Disa herë e kishin parathënë dhe shpallur vrasjen e Jasharëve dhe asnjëherë nuk e kishin besuar. As tani nuk e besonin.

Krimi ndaloi pranë shkallëve të kullës së dytë , ku kishte rënë Adem Jashari.. Dukej sikur kishte rënë të pushonte, do të kujtonte mbesa e tij më vonë, por asaj dite, qartësisht, njëri nga të çarturit pyeti, në se ai që ishte aty, pranë shkallëve, ishte Adem Jashari. Ajo e dinte se mixha ishte vrarë, e kishte parë çastin kur kishte ndodhur gjithçka, por të të çarturit nuk ishin të sigurt. Mixha i saj, pak ditë më parë, e kishte shkurtuar mjekrën dhe të çarturit ishin të pasigurt në njohjen e tij. E pyetën edhe një herë, dhe vajza e vogël, krejt qetësisht, sikur deri atëherë të mos kishte ndodhur asgjë, iu përgjigj se "Ky nuk është mixha im, është një dajë prej Llaushës". Nuk donte të pranonte vdekjen apo kishte diçka krejt tjetër?

Që ishte vrarë, ajo e dinte, që një njeri si mixha i saj nuk mund të vdiste, edhe këtë e dinte.

Policët serbë, krejtësisht të çartur, ndërsa shpejtonin të hiqnin të vrarët e tyre, duke u sjellë rreth e rrotull shtëpive. Shtëpitë dhe kullat vazhdonin të digjeshin. Trarët vazhdonin të përthyheshin njëri pas tjetrit. Gurët po bëheshin gjithnjë e më tej të bronztë. Gjithçka ishte bërë tashmë e lemerishme rreth atij peizazhi, njerëzit nga larg vazhdonin të shikonin kullat që digjeshin, që po ktheheshin dalëngadalë në një muranë të zjarrtë.



15 muaj më vonë, kur e kam takuar për herë të parë Besartën, krejt natyrshëm, e kam pyetur në se kishte pasur frikë, e kam pyetur sepse e përfytyroja llahtarinë përmes së cilës mund të kishte kaluar, kur pranë saj ishin të pajetë njerëzit më të dashur, babai e nëna, motra e vëllezërit, gjyshi e gjyshja, bali Adem e nuset e shtëpisë, kushërinjtë e parë dhe të tjerët nga Fisi i tyre.

Besarta më pat thënë atëherë se, "sa këndonte bali Adem, kurrfarë frike nuk kam pasur". Më tha ashtu dhe unë e besova menjëherë. *(Vijon)*

# Mos merrni vendime të shpejta, se edhe më shpejt do ta thyeni qafen!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

**Kush ngutet për... jargohet:** Nuk ka popull si ne shqiptarët që, me merita të tjetrit, i këndojmë vetes ose, përkthyer në shqip, "bëhemi dhëndër me rekuizite të tjetrit". Kur në mesverë të vitit 1990, burgun e vogël në llogorin e Stara Gradishkës e zëvendësova me burgun e madh të quajtur Kosovë, në mungesë të informacioneve dhe një zbrazëtie në fushën e muzikës, pata humbur ndjesinë se kush ishin heronjtë shqiptarë, ata që bënë vepra heroike që nga viti 1974 e deri në vitin 1989, në kohën e "kryengritjes së madhe" të udhëhequr nga atdhetari i madh, që nga koha e Josip Broz Titos e deri kur Slloba e futi në birucë (ende nuk e kam të qartë pse?!), Azem Vllasin dhe të ngjashëm me të që me mish e me shpirt i shërbyen Jugosllavisë së Titos dhe asaj të Zhablakut por, thuaja të gjithë këta, e sidomos pasardhësit e tyre biologjikë, fiziologjikë dhe patologjikë, rehatinë dhe shtatë palë qejfe i shijuan gjatë sundimit të Hashim Thaçit dhe të tjerë, që dikur trimërisht, pikërisht kur ishte nevoja, luftuan deri në sakrificë, kurse tani kur nuk ishte fare nevoja, u bënë përrallë dhe gazi i botës. Pas demonstratave të vitit 1981, kur isha student në Sarajevë dhe kur shqiptarët që ishin një komunitet i fuqishëm njerëzor, kombëtar, politik, artistik, sportiv dhe i biznesit filluan të organizohen, për t'i disiplinuar erdhi në Sarajevë një gjysh i një këshilltari të Albin Kurtit i cili, pasi u takua me udbashët boshnjakë dhe me vëllezërit Pozderac, erdhën në përfundim se "treba da se kazne primerno iredentisti i valikoalbanski nacionalisti da se da primer drugima koji su protiv Jugoslavije i bratstva i jedinstva", në shqip: "Duhet të dënohen në mënyrë shembullore irredentistët dhe nacionalistët shqiptaro-mëdhenj për t'u dhënë shembull (mësim) atyre që janë kundër Jugosllavisë dhe vëllazërim-bashkimit...". Dhe koka turku, por me përmbajtje puro kombëtare ishim: unë, një studente nga Peja, Hidajete Krasniqi dhe një shqiptar nga Kumanova që punonte si punëtor krahu. Me dhjetëra e qindra studentë shqiptarë dhe punëtorë u morën në pyetje nga Shërbimi i Sigurimit të Jugosllavisë, në mesin e të cilëve kishte të tillë që edhe pranuan të dëshmojnë ose u bënë vegla të këtij sigurimi. Realisht politikanët e Kosovës të asaj kohe që flisnin shqip ndërsa mendonin dhe vepronin serbisht e që erdhën në Sarajevë me propozime konkrete se kush duhet të arrestohej, na futën në burg, kurse boshnjakët vetëm e ekzekutuan një vendim politik. Shihni bijtë dhe bijat e këtyre udbashëve shqiptarë, nipat dhe mbesat si jetojnë sot, mos janë vallë të papunë, janë raste sociale apo nuk janë mjaftueshëm të respektuar nga udhëheqësit e institucioneve apo nga vetë institucionet. Nuk ka të ngjarë të jetë kështu, jetojnë si veshka në dhjamë dhe janë të respektuar nga të gjithë; Hashimi, Fatmiri, Bekimi, Rama dhe të tjerë, hiç këtu disa përjashtime të vogla, të papërfillshme fare. Shihni fëmijët tanë ku janë, të papunë, të nëpërkëmbur, por me dinjitet të ruajtur për dallim nga të padinjitetshmit që dikur i kemi llogaritur si shokë, bashkëvuajtës dhe bashkëveprimtarë!

Gjatë kohës së vlimeve të mëdha në Kosovë e që i përcillnim nga Llogori i Stara Gradishkës, autoritetet kriminale jugosllave, serbe dhe udbashët e Kosovës që na futën në burg në Sarajevë, ushtronin dhunë dhe terror mbi të rinjtë dhe të rejat shqiptare në Kosovë dhe të gjithë atyre që e donin lirinë, pavarësinë dhe bashkimin kombëtar. Madje, dhuna që e ushtronin këta shqipfolës ishte shumë më e madhe se që e përdornin inspektorët apo hetuesit nga Serbia apo Kosova e që ishin serbë. Mirëpo edhe këta udbash dhe kriminelë që flisnin shqip, pas përfundimit të luftës u sistemuan më mirë se në kohën e Milloshevniqit. Sidomos fëmijët e tyre që me asnjë veprim nuk u distancuan nga krimet që i kishin bërë baballarët dhe majkat e tyre. Një hetues kriminel i quajtur Gazmend Maliqi, nga fisi i shquar në shërbim jugosllav dhe serb, thuaja një vit e ka torturuar çnjerëzisht në burgun e Mitrovicës dhe të Prishtinës Fexhrie Bilallin, tash Shala, studente dhe aktiviste politike dhe kombëtare dhe për këtë askujt nuk i ka dhënë llogari. Shihni fëmijët e këtij krimineli ku janë, si janë sistemuar dhe shihni fëmijët e mi apo të atyre që tërë jetën ia kushtuan luftës për liri dhe çlirim, frytet e së cilës po i gëzojnë përndjekësit tanë dhe fëmijët e tyre.

Pasi dola nga burgu i parë (në vitin 1983), gjatë shërbimit të dhunshëm ushtarak në armatën jugosllave (në Ilirska Bistrië të Sllovenisë), më dënuan 12 vjet burg. Dëshmitarët kryesorë në këtë proces të montuar politik ishin një bashkëpunëtor i Shërbimit Jugosllav nga fshati Llugë i Besianës dhe një nga Malisheva e Gjilanit. Ai nga Lluga e Besianës, pasi kreu detyrën me sukses, "iku" në Gjermani, ku organizonte demonstrata të mërgatës shqiptare duke u vënë në ballë të tyre, me flamurin kombëtar në duar dhe atë jugosllav në zemër. Kur një shok imi që jeton në Gjermani m'i tregoi fotot nga demonstratat e shqiptarëve në Gjermani, duke e lavdëruar këtë patriotin e udbës, pasi i thashë se kush është ai, mbeti pa fjalë dhe ende ishte si në ëndërr, nëse ishin të vërteta fjalët e mia apo "patriotizmi" i fëlliqësirës njerëzore dhe kombëtare nga Lluga e Besianës. Ndërkaq, një palaço i pafytyrë nga Malisheva i Gjilanit, me dëshminë e rrejshme, por që e bënte me loçkë të zemrës, kontribuoi që të dënohen ushtarët shqiptarë: Hysen Shurdhani, 12 vjet, Zenel Baçaj, 9 vjet, Shefki Barileva, 7 vjet, Brahim Mazrekaj, 6 vjet, Hysen Zymberi, 6 vjet, Isa Jashari, 6 vjet, Fatmir Ahmeti, 4 vjet, Behxhet Shala, 12 vjet dhe Rrahim Rama, 1 vit. Po i njëjti, jo që nuk kërkoi falje për këtë, por arriti të bëhet një ndër aktivistët e devotshëm të PDK-së në atë pjesë të Kosovës. Udhëheqësit e kësaj partie kanë qenë të njoftuar për këtë por... gjendja nuk ka ndryshuar. Një mik më tregoi se në protestat kundër votimit të Avdullah Hotit për kryeministër, po i njëjti, tash nga pozita e aktivistit të LV-së, paska qenë shumë aktiv duke kërkuar t'i vihet zjarri Kuvendit të Kosovës, si çerdhe e kriminelëve sepse u dashka të luftohen tradhtarët e kombit dhe të korruptuarit duke bërë përpjekje të largohet nga e kaluara e tij krejtësisht e poshtër, kriminale dhe tradhtare. Një oficer i Shërbimit Kundërzbulues të Ushtrisë jugosllave që ka kurdisur procese politike kundër ushtarëve shqiptarë, pas përfundimit të luftës, ishte rehatuar në institucione të Kosovës ku gëzonte respekt të plotë dhe reputacion prej një atdhetari të devotshëm. Këto janë vetëm tri raste që janë fërkuar për mua dhe familjen time, që jetojnë si është më së miri dhe janë më të respektuar se shumica prej nesh që e kemi paguar me shpinë dhe kokë lirinë që ne e gëzojmë vetëm pjesërisht, kurse ata e keqpërdorin krejtësisht. Në radhë të parë të përkrahur maksimalisht nga ata që e kanë pasur për detyrë të mos e lejojnë përsëritjen e dhunës ndaj nesh dhe popullit, por se edhe vetë hynë në vallen e tyre. Turp iu qoftë nëse ende e njohin turpin, qoftë edhe si kategori gjuhësore!

Shpejtësia e pabesueshme e marrjes së vendimeve në kohë të pandemisë: Albin Kurtin e rrëzuan shpejt dhe lehtë, jo pse këta ishin të fortë, por shkaku se Albini e rrëzoi veten duke i rrënuar të gjitha urat e bashkëpunimit, duke i harruar aktivistët dhe përkrahësit e vërtetë, duke bërë armiq të imagjinuar dhe miq të rrejshëm, duke vënë në pozita gjene të udbashëve, duke kërkuar nënshtrim në vend të bashkëpunimit dhe duke vënë në poste të larta shtetërore të tillë që as për të qenë operativistë të UDB-së nuk i plotësonin kriteret. Majat e larta të Kilimanxharos kosovare e përplasen përtokë Albinin sikur edhe lufta e Don Kishotit me "armiqtë" e sajuar. Po del se më i zoti për mbajtje të pushtetit ishte princ Vidi në Shqipëri, se Albini në Kosovë. Albini, mençurinë, shkathtësinë, bashkimin kombëtar, patriotizmin dhe doktrinën politike e ambalazhoi në atë mënyrë që e shndërroi si një mall 0.99 cent, ku ka shumë blerës të cilët me ta mësuar cilësinë e mallit të propozuar e që është në shpërputhje me atë që e blenë, më nuk do të ngarendin pas këtij malli! Nënvlerësimi dhe nënçmimi i kundërshtarit, në jo pak raste ta hanë kokën politike dhe, në disa raste, jo vetëm politike. Albini deshi të bëhej gjeneral i gjeneralëve dhe jo gjeneral i ushtarëve, prandaj edhe i ra flamuri në lojën e shpejtë të shahut politik! Është e vërtetë se të gjithë u bënë kundër Albinit, por shtrohet pyetja pse u bënë dhe pse lejoi të bëhen. Jam i sigurt se po të bënte një politikë tjetër, pa sakicë në krah, Albin Kurti do të ishte kryeministër së paku dy mandate. Albini i preu të gjitha bordet (dardhat) për t'i mbjellë bordet (dardhat) e veta! Në poste shumë të rëndësishme vendosi persona krejtësisht të parëndësishëm, por që i bindeshin krejtësisht. Nuk ka asgjë më keq se kur injorantin dhe injorancën i vishni me pushtet sepse e fuqizoni dhe e bëni të rrezikshëm, së pari për kundërshtarin e pastaj për vetë liderin, në rastin konkret Albinin. Albin Kurti nuk është dashur të rrëzohej, së paku jo më herët se 1-2 vjet. Për mua është shumë e pamoralshme koha kur është rrëzuar Albini e sidomos motivi për çka është rrëzuar. Nuk mbeti rregëzinë e pozitës apo edhe e opozitës pa e cilësuar Albinin si antiamerikanë, kundër Trampit, kundër Grenellit, kundër Monika Llevinskit dhe kundër Igor Stravinskit! Në një mjedis me demokraci qoftë edhe në gjurmë askush nuk mund të penalizohet nëse nuk e don Trampin apo Grenellin e lëre më të rrëzohet nga pushteti. Albin Kurti deshi të luajë koçe me Hashim Thaçin - Shimën, kurse pikërisht Shima e la Albinin pa koç... të kryeministrit! Mjerim, thënë më së buti!

Tash në skenë e kemi Dullën kryeministër. Avdullah Hotin. Një burokrat dhe teknokrat par exellance. Nuk është njeri i keq. Në proceset që e presin Kosovën Dulla mund ta vendosë mbi tavolinë të bisedimeve një projekt të shkruar nga të tjerët ama, pos projektit, tavolinën duhet ta rrahësh edhe me koç... këtë Dulla nuk e bën dot. Është intelektual dhe i butë! Po e shihni me sa shpejtësi po i largon të gjitha pengesat ndaj Serbisë, pa e bërë asnjë frenim. Pa fituar asgjë si kundërvlerë. Qoftë as edhe si premtim! Politikanët e Kosovës, në mungesë të guximit apo dijes politike për vendimmarrje, reciprocitetin, si masë normale që e përdorë çdo vend normal përballë një vendi që nuk ka sjellje normale, e ka bërë si karikaturë politike; ne po e heqim reciprocitetin si një instrument i ligjshëm dhe i pranuar ndërkombëtarisht për rregullim të marrëdhënieve midis shteteve, kurse Serbia duhet ta ndërpresë fushatën për çnjohje të pavarësisë së Kosovës, e sajuar nga Serbia si diçka që praktika ndërkombëtare nuk e njeh dhe as nuk e pranon. Realen po e zëvendësoni me të paqenën, kurse të vërtetën, me të pavërtetën. Ose, ta banalizoj krejtësisht: kjo i bie sikur kur bëni tregti kur kundërshtari ua ofron lëkurën e qenit të zgjebosur, kurse ju ia ofroni lëkurën e tigrit bengalez! Kjo shpejtësi e pabesueshme e marrjes së vendimeve, 100 për qind lehtësuese për Serbinë të cilën e përshëndesin Trampi, Grenelli, Lajçaku dhe Borrelli, të gjithë ambasadorët dhe konsujt realë dhe të nderit, Ivica Daçiqi dhe Marko Gjuriqi, Aca Vuçiqi dhe Vuk Drashkoviqi si dhe diaspora politike në Kosovë (Hasha, Kadria, Fatmiri dhe Isa) sikur edhe krejt kabineti qeveritar, më bënë shumë dyshues. Nuk dua t'ia trazoj ëndrrat e një nate vere të Dullës të cilit dukshëm i janë rritur rruazat e kuqe të gjakut që po vërehen në lëkurën e fytyrës që i është bërë kuq si gjaku si i një molle të Kovrragës së Istogut apo një adoleshenti të dashuruar rishtas por, shumë po më brengos kjo nguti dhe ky entuziazëm i çastit që po përkthehet edhe si triumf ndaj Albinit! As Dulla dhe askush nuk mund të marrë ndonjë vendim të rëndësishëm për Kosovën duke pasur 60 deputetë shqiptarë në opozitë (nëse PDK-ja vërtet do të sillej si opozitë). Nuk janë miqtë ata që do të duhej të marrin vendime për ne, pa na pyetur fare, por vërtet janë miq nëse na përkrahin kur marrim vendime në të mirë të Kosovës dhe qytetarëve të saj pavarësisht prej përkatësisë etnike. Vendime që janë në dobi të Kosovës, por që nuk e dëmtojnë askënd! Nuk mund të vendosin për Kosovën dhe kundër Kosovës ata që asgjë nuk kanë bërë dhe dhënë për këtë vend, por se vetëm kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin, si në bahçe të babës nga ky vend!

# Dr. Ermira Babamusta rrëfen për besimin politik në Kosovë





EPOKA E RE **Lulëzim ETEMAJ**

**Prishtinë, 9 qershor** - Si rezultat i një studimi të thelluar shkencor 10-vjeçar, Dr. Ermira Babamusta ka botuar në fund të majit në gjuhën angleze librin “Political Trust in Kosovo” (“Besimi politik në Kosovë”).

Autorja është eksperte dhe ligjëruese me përvojë shumëvjeçare në ShBA, duke qenë pjesë e “Speakers Bureau” - Byrosë së Folësve Motivues.

Pas vetes ka një përvojë të pasur profesionale, përfshirë Departamentin e Sigurisë së Atdheut në Amerikë; AmeriCorps Vista në Nju Jork; Këshillin e Kongresit Amerikan për Udhëheqjen e Rinisë (Congressional Youth Leadership Council); Departamentin e Paqes në OKB; Administratën e Presidentit Barac Obama dhe Kongresin Amerikan në të dyja dhomat, Senatin Amerikan dhe Dhoma e Përfaqësuesve (U. S. House of Representatives).

Dr. Babamusta njëherësh ishte edhe drejtoreshë e fushatës presidenciale të presidentit të 44-t të ShBA-së, Barack Obama.




Libri “Besimi politik në Kosovë” është në fokusin qendror të intervistës së bërë me të për gazetën ditore “Epoka e re”.

**“Epoka e re”:** *Zonja Babamusta, në fillim të majit keni botuar librin tuaj studimor “Besimi politik në Kosovë” (Political Trust in Kosovo). Cilave kategori mund t’u hyjë në punë ky libër dhe për çfarë?*

**Ermira Babamusta:** Përshëndetje z. Lulëzim për ju dhe lexuesit e gazetës së mirënjohur “Epoka e re”. Faleminderit për këtë bashkëbisedim! Libri “Besimi politik në Kosovë”, botuar nga NY Elite Press, është pjesë e Bibliotekës së Kongresit Amerikan. Libri fillimisht është botuar në anglisht dhe është i gatshëm në formatin botim shtypi dhe Kindle në Amazon. Libri i përket kategorisë “nonfiction” në shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare, proceset politike dhe lidershipi.

Libri “Besimi politik në Kosovë” është një punim shkencor 10-vjeçar që ngre pyetjen: A ndikohet besimi politik nga vendimmarrësit politikë apo nga institucionet politike? Libri analizon nga ana teorike dhe praktike në nivelin makro (performanca e institucioneve) dhe mikro (përvojat individuale) debatin kulturor-institucional mbi besimin në politikën e Kosovës. Ky hulumtim bën dallimin midis besimit drejt sistemit (p. sh., sistemi i politikës) nga besimi i politikës nacionale (si, p. sh., qeveria, liderët, policia, gjykata etj).

**“Epoka e re”:** *Duke qenë se libri i kushton vëmendje periudhës para dhe pas pavarësisë së Kosovës, a ka një vazhdimësi të besimit politik si në rrafshin nacional, po ashtu dhe atë ndërkombëtar, nga njëra periudhë në tjetrën, apo kemi një riformulim komplet të tij?*

**Ermira Babamusta:** Libri sjell një hulumtim sasior me të dhëna origjinale të mbledhura në Kosovë, Amerikë dhe në Angli për ta kuptuar: (1) situatën politike në Kosovë, (2) kuadrin ligjor, (3) rolin e komunitetit ndërkombëtar. Kjo është bërë për t’i kuptuar faktorët influencues para dhe pas pavarësisë, duke marrë vitin 2008 si pikë bazë të harkut kohor (para 2008 dhe pas 2008).

Hulumtimet botërore kanë mbledhur të dhëna nga shtetet evropiane dhe nga Perëndimi, ndërsa të dhënat në vendet demokratike të reja ose tranzionale janë të pakta. Po ashtu, edhe në Kosovë, për arsye të luftës dhe boshllëkut në qeverisje para pavarësisë, ka mungesë të theksuar të të dhënave.

Libri sjell të dhëna të mbledhura gjatë dy vizitave të mia në Kosovë 2012-2013 me 220 pjesëmarrës në anketim dhe në vitin 2017-2018 me 40 ekspertë elitarë.

**“Epoka e re”:** *Sipas studimit tuaj, cili në të vërtetë është aktualisht besimi politik nacional i qytetarëve të Kosovës dhe cilët janë faktorët determinues të tij?*

**Ermira Babamusta:** Punimi shkencor është dizajnuar për t’i hulumtuar tre dimensionet e besimit politik: (1) institucionet qeveritare, (2) institucionet ligjore, dhe (3) aktorët (ku përfshihen komuniteti ndërkombëtar, BE, OKB, NATO) në periudha të ndryshme, për të kuptuar ndryshim në popullatë ndaj besimit politik në Kosovë.

Studimi ngriti pyetjen: A keni besim në Qeverinë e Kosovës? Për vitin 2018 vetëm 20 % u përgjigjën po që kanë besim dhe një numër i madh 80 % thanë jo. 84 % janë të mendimit të bashkimit me Shqipërinë; 85 % mendojnë që Kosova mund ta qeverisë veten dhe 91 % mendojë se Kosova ka nevojë për ndryshim në qeverisje.

Duke pasur parasysh ndryshimet në perceptime midis grupeve kulturore, brenda dhe jashtë vendit, banorëve dhe të huajve, studimi tregon një mosbesim të theksuar nga qytetarët vendas (89.08 % nuk kanë besim nga qytetarët me përkatësi kombëtare shqiptare në Kosovë) në krahasim me 62.5 % e të huajve që nuk kanë besim në politikën e Kosovës. 37.5 % e të huajve kanë besim dhe vetëm 10.95 % e shqiptarëve që kanë besim. Kjo tregon se shqiptarët e Kosovës kanë pika të ulëta të identitetit dhe besimit politik. Po ashtu, 85 % e qytetarëve të Kosovës me banim jashtë shtetit nuk kanë besim politik në Kosovë.

Studimi gjeti një lidhje pozitive midis identifikimit nacional dhe besimit politik. Ndjenjat e dobëta të krenarisë kombëtare ose lidhjes me kombin shoqërohen me besim të ulët në qeveri. Për më tepër, studimi zbulon se pakënaqësia me simbolet kombëtare të shtetit ka një ndikim negativ në identitetin kombëtar dhe e zvogëlon ndjenjën e kohezionit në shoqëri.

Sondazhi, gjithashtu, shtroi një pyetje tjetër: “Si identifikohet një serb nga Kosova?”, duke parashtruar këto katër zgjedhje për përgjigje: (1) Serb; (2) Kosovar; (3) Serbo-kosovar; (4) Tjetër (shpjegoni). Rezultatet tregojnë se shumica e serbëve të Kosovës e identifikojnë veten si “serb” (72 %); ku 22.4 % e identifikuan si “serb-kosovar”; 4.6 % thanë “kosovar”; dhe 1 % thanë “Tjetër”, duke renditur “Serb nga Kosova & Metohija”.

Sondazhi, gjithashtu, pyeti: “A mendoni se serbët në Veri ndihen se janë qytetarë kosovarë?” Me një përgjigje “po”, “jo” dhe “pjesërisht”, rezultatet tregojnë se shumica e 59 % përgjigjen “jo”; 33.3 % thanë “pjesërisht” dhe vetëm 7.3 % thanë “po”. Pra, ekziston një shkëputje e madhe midis grupeve të pakicave etnike në Kosovë dhe identitetit kombëtar dhe etnik. Kjo shkëputje (jo unitet) shfaqet në shifrat e larta të mosbesimit në politikën e Kosovës.

**“Epoka e re”:** *Përderisa rezultatet e studimit e nxjerrin përqindjen e besimit të qytetarëve të Kosovës në institucionet vendore në shkallë të ulët, ndryshe qëndron puna me institucionet ndërkombëtare. Cili është shpjegimi juaj, ju lutem?*

**Ermira Babamusta:** Rezultatet tregojnë një ndryshim të dukshëm midis besimit politik në institucionet vendore nga ato ndërkombëtare. Saktësisht, vetëm 30 % kanë besim në gjykatat vendore në Kosovë, duke e krahasuar me 70 % besim në Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë për vitin 2018. Ndërsa shqiptarët si në vend dhe ata me vendbanim jashtë shtetit kishin të njëjtin nivel të mosbesimit në Qeverinë e Kosovës. Kurse të huajt treguan një nivel më të lartë të besimit në Qeverinë e Kosovës në krahasim me shqiptarët.




Edhe pse raporti i studimit tregon një nivel të ulët në Qeverinë e Kosovës, studimi zbulon se Ambasada Amerikane (70 %) dhe Policia e Kosovës gëzojnë besimin më të lartë. Nga institucionet e huaja, NATO mori përqindjen më të lartë të besimit politik me 84 %, vijuar nga BE-ja me 77 % dhe OKB-ja vetëm me 51 %. Ndryshimi i theksuar midis institucioneve vendore dhe ndërkombëtare është i ndërthurur me performancën, ose me pa/kënaqësinë ndaj performancës të institucioneve përkatëse.

Mendoj se Kosova ka nevojë për një frymë të re që ecën me demokracinë, zhvillimin dhe drejtësinë, duke vlerësuar rolin e rëndësishëm që Kosova luan në rajon për siguri ndërkombëtare dhe duke vazhduar miqësinë me aleatët NATO-Amerikë-Angli-Gjermani. Njëkohësisht duke fuqizuar strukturat e brendshme vendore, që Kosova të ketë një zë më të fuqishëm për ta influencuar Ballkanin. Lëkundjet në qeverisje nga sezoni në sezon për interesa vetjake politike po shpalosin një demokraci të brishtë dhe të lëkundshme, që reflekton edhe imazhin jo të fortë të Kosovës në botë.

**“Epoka e re”:** *Duke qenë se librin e keni botuar në gjuhën angleze, kur mund të llogarisin ta kenë lexuesit që kanë interesim për ta lexuar në gjuhën shqipe?*

**Ermira Babamusta:** Momentalisht po merrem me përkthimin e 300 faqeve të librit nga anglishtja në shqip dhe shpresoj se për 2-3 muaj ta kem gati edhe për publikun shqiptar për botim në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

E jashtëzakonshme

## Fshati që është nën ujë që nga viti 1994 mund të shfaqet përsëri



Një fshat italian i shekullit të 12-të, i zhytur nën ujë për më shumë se 25 vjet, shpejt mund të shihet përsëri. Fshati Fabbriche di Careggine, në provincën Lucca, Toscana, u përmbyt në vitin e largët 1946 për të ndërtuar një digë dhe ai fshat u pa për herë të fundit edhe një herë kur liqeni u zbraz në vitin 1994.

FOTO E DITES



Dy fëmijë në Francë shihen duke luajtur në një fushë lulëkuqe. /Reuters/

E rrallë

## Babai u ndërton fëmijëve rrëshqitëse në shtëpi duke përdorur kuti nga kartoni





Një baba kreativ u ndërtoi fëmijëve të tij një rrëshqitëse nga shkallët e shtëpisë për t'i argëtuar ata gjatë bllokimit nga pandemia. Sipas mediave të huaja, Parker Wood nga ShBA vendosi t'i përdorte të gjitha kutitë e kartonit që kishte në shtëpinë e vet dhe të krijonte aktivitet argëtues për fëmijët.

## BARSOLETA E DITËS



- A e di që djali im i madh është kopja ime?
- Kjo ndodh për shkak të ndikimit të gjeneve.
- Vërtet? E pse djali im i vogël ngjan me fqinjin?
- Ndodh për shkak të ndikimit të rrethit.

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00

### Spies in Disguise 3D




I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno




Në ora 18:00

### Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

**Regjia:** Jake Kasdan

Çdo natë në ora 20:00

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D




Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

**Regjia:** J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Aftësitë e tua të komunikimit janë aq të forta si kurrë më parë, kështu që gjasat janë që gjërat të arrini t'i përmbushni me sukses.



**DEMI**
Gjendja emocionale mund të ketë luhatje, por nëse reagoni në mënyrë të gabuar mund të pendoheni më vonë.



**BINJAKËT**
Kjo është një kohë shumë emocionuese për ju, plot mundësi të reja, veçanërisht në fushën e udhëtimit.



**GAFORRJA**
Papritmas, të gjithë duket se jua mbyllin dyert në punë. Por, vërini një kapak paranojës tuaj.



**LUANI**
Një mik i cili ka fituar shumë autoritet profesional po fillon ta nxjerrë në pah dëshirën për të rënë në sy.



**VIRGJËRESHA**
Nëse keni ende atë ndjenjë të pakëndshme për punën tuaj, atëherë është koha të mendoni për situatën me logjikë të ftohtë.



**PESHORJA**
Mundohuni të gjeni dikë me të cilin ndani të gjitha emocionet tuaja. Gjatë kësaj rruge ju do të jeni në gjendje t'i organizoni mendimet tuaja.



**AKREPI**
Ndonjëherë pasiguria mund të jetë emocionuese dhe jo aq e frikshme. Nëse mund ta shihni këtë situatë misterioze në mënyrën e duhur, mund ta kaloni rrezikun me sukses.



**SHIGJETARI**
Nesër mund të krijoni një raport interesant i cili me kalimin e kohës do të bëhet edhe më i këndshëm. Sa i përket një hulumtimi, tregoni guxim dhe të ardhurat nuk do të mungojnë.



**BRICJAPI**
Komunikimi ndërmjet jush dhe njerëzve tuaj ka qenë i çrregullt dhe sjellja e dikujt po ju bën të mendoni me të drejtë se premtimi nuk do të mbahet.



**UJORI**
Në marrëdhëniet ndërpersonale, pritshmëritë e mëdha mund t'ju zhgënjejnë nesër. Pra, bëni maksimumin që të përqendroheni në të tashmen.



**PESHQIT**
Ka shumë lëvizje rreth jush dhe ajo që dëshironi mund të vijë te ju vetë, nëse jeni të durueshëm.

# Rita Ora publikon një video të ëmbël nga fëmijëria




Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Rita Ora, ka ngritur zërin së fundmi kundër çështjeve të racizmit. Ajo ka publikuar vazhdimisht këto ditë imazhe të organizatave që merren me të drejtat e njeriut. Së fundmi ajo ka publikuar për ndjekësit e saj në rrjetin social "Instagram" disa video të shkurtra të realizuara në vitin 1994. Videoja e shfaq Ritën të lumtur si fëmijë teksa shëtit në park dhe ndjek pëllumbat.




# Dafina Zeqiri rrëfen luftën me depresionin: Psikologia u çudit kur më pa

Edhe Dafina Zeqiri ka folur për depresionin. Pa komplekse këngëtarja është shprehur se ka vuajtur nga kjo sëmundje, madje edhe është konsultuar me psikologen. E ftuar në NIN në "Klan Kosova", këngëtarja tregoi se depresioni është shumë gjë normale dhe ne duhet ta ndihmojmë njëri-tjetrin. "Pse po më vjen në zyrë, je fytyrë publike'. I thashë le të më shohin, kjo është njësoj sikur shkon te mjeku për dhimbje koke, lukthi apo të ka zënë koronavirusi. Krejt ata që e kanë kaluar depresionin është diçka shumë normale".

# Dj Geek nuk mund të 'jetojë' pa Dafinën, çfarë po ndodh mes çiftit?!



Ndarja e këngëtares së njohur, Dafina Zeqiri nga Dj Geek, erdhi e papritur për të gjithë pasi dyshja shfaqeshin shumë të dashuruar me njëri-tjetrin. Dafina tregoi se i duhej të bënte një zgjedhje midis punës dhe dashurisë e për të mos prishur harmoninë në punë vendosi t'i jepte fund lidhjes. Megjithatë, ajo dhe Dj Geek kanë treguar se ruajnë një marrëdhënie mjaft të mirë, madje ai vazhdon ta mbështesë Dafinën në të gjitha projektet e saj. Ndërsa së fundmi një postim i Dafinës i ka konfuzuar të gjithë. Këngëtarja shqiptare ka publikuar një video të Dj Geek ku shkuan se ai nuk mund të jetojë pa të. A është kjo një tregues i marrëdhënies së tyre të mirë apo një shkëndijë e re mes tyre?!

# Mc Kresha bëhet baba për herë të parë, vjen në jetë Iza





Mc Kresha është bërë baba. Pritjes së ëmbël i ka ardhur fundi, ndërsa bashkëshortja e tij, Erzina Shehu, ka sjellë në jetë vajzën e tyre të parë. Ka qenë babai i Erzinës i cili u ka zbuluar "sekretin" çiftit". Ximi Shehu, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", ka uruar çiftin, teksa ka zbuluar edhe emrin e fëmijës. "Mirëserdhe në jetë Iza. Jeta jote qoftë e uruar nga Zoti, vetëm me të mira, por edhe stuhitë e jetës kurrë mos të lakofshin", ka shkruar ai.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Përkujtohet emblema e futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri

Legjenda e futbollit të Kosovës, ish-kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, është përkujtuar në dyvjetorin e vdekjes. Në shenjë nderimi për Vokrrin janë bërë homazhe, kurse në stadiumin që e mban emrin e tij në Prishtinë është zbuluar maketi i shtatores fituese. "Është një sukses i jashtëzakonshëm që i është dashur qeverisë dhe shtetit të Kosovës. Pa dyshim Vokrri mbetet legjenda edhe për brezat që vijnë. Ne jemi të nderuar që sot e bëmë zbulimin e maketit për shtatoren e Vokrrit, para së cilës në të ardhmen do të përkulen sportistët dhe legjendat e ardhshme të futbollit", ka thënë Hoti



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

**Prishtinë, 9 qershor** - Legjenda e futbollit shqiptar dhe ish-kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrri, është kujtuar në dyvjetorin e vdekjes. Vokrri ndërroi jetë në mënyrë tragjike më 9 qershor të vitit 2018, pas një sulmi në zemër, në moshën 57-vjeçare. Drejtues të institucioneve shtetërore dhe institucioneve sportive, klube e sportistë të ndryshëm, Fadil Vokrrin e kanë vlerësuar lart për paraqitjet si futbollist dhe për punën e madhe si kryetar i FFK-së.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Vokrri dashurinë për futbollin e ka shndërruar në kontribut jetësor për Kosovën. "Dashurinë për futbollin e shndërroi në kontribut jetësor për Kosovën. Në dyvjetorin e vdekjes e kujtojmë legjendën Fadil Vokrri, i cili e zhvilloi dhe ndërkombëtarizoi sportin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Me profesionalizimin, urtësinë dhe vizionin e tij, Vokrri arriti ta anëtarësojë Kosovën në UEFA dhe FIFA. Gjithmonë mirënjohës për kontributin e tij!", ka thënë Thaçi.

Ndërsa ish-kryeministri i Kosovës dhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë homazhe te varri i Fadil Vokrrit në dyvjetorin e vdekjes së legjendës së futbollit të Kosovës. "Bashkë me deputetët z. Shpejtim Bulliqi, znj. Saranda Bogujevci, z. Fitim Haziri dhe z. Yll Rugova nderuam veprën dhe jetën e Fadil Vokrrit, legjendës së futbollit e të sportit, në dyvjetorin e vdekjes së tij", ka thënë Kurti. "Fitoret e Prishtinës ishin të lidhura me emrin e tij. Vokrri ishte arsyeja e fitores sepse kur topi ishte në këmbën e tij, ai e pushtonte fushën. Tregojnë bashkëlojtarët e tij, me gjysmë shaka: 'Kur ndeshja ishte sfilitëse dhe donim të pushonim, ia kalonim topin Fadilit'. Kështu ishte edhe në Federatë. Punoi shumë e pa u lodhur për pasionin e vajzave e djemve tanë", ka shtuar Kurti.



Kontributin e Fadil Vokrrit e kanë vlerësuar lart edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli dhe ai i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj.

Ndërsa ministrja e Sportit, Vlora Dumoshi, në dyvjetorin e shkuarjes së Vokrrit në amshim, ka thënë se Fadili është i pavdekshëm dhe kontributi i tij ishte i jashtëzakonshëm për sportin e Kosovës. "Fadil Vokrri ka qenë njeri shumë i madh. Ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për sportin në Kosovë në faza të ndryshme të jetës, sidomos në pjesën e fundit ka arritur që futbollin e Kosovës ta anëtarësojë në FIFA dhe UEFA. Vokrrin do ta respektojnë gjenerata e gjenerata që do të vijnë. Me kontributin e tij, ai është i pavdekshëm", ka thënë Dumoshi.

Ndërkohë ish-bashkëpunëtori më i ngushtë i Vokrrit, Agim Ademi, që aktualisht është kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës, ka thënë se kontributi i Vokrrit tashmë është shkruar me shkronja të arta në histori. "Mëngjesi i 9 qershorit 2018 ishte tronditës për të gjithë ne. Kosova mbeti pa ty legjendë, që tërë jetën ia kushtove futbollit dhe punove pareshtur për zhvillimin dhe progresin e tij. Sapo kishte kaluar ora 9:00 e atij mëngjesi të kobshëm, zemra të tradhtojë. Të mori pikërisht numri që të simbolizonte. Ike nga kjo botë për të shkuar në përjetësi si legjendë. Kontributi yt tashmë është i shkruar me shkronja të arta në histori", ka thënë Ademi. "Gjithmonë do të mbetesh motivi më i madh i lojtarëve tanë të cilët çdo sukses të përfaqësueses e lidhin me emrin tënd, teksa 'Dardanët' në çdo ndeshje thërrasin me mburrje e krenari në minutën e 9-të në stadiumin, që është bërë ankth për çdo kundërshtar në fushë, 'Fadil Vokrri'", ka shtuar Ademi. Fadil Vokrri e filloi karrierën si futbollist në skuadrën e Llapit, por si profesionist debutoi në skuadrën e Prishtinës në vitin 1980. Më pas karrierë bëri edhe në Partizan, Nimes, Fenerbahçe, Bourges 18. Në fund të karrierës së tij, në vitin 1995, ai u pensionua në klubin Montlucon. Vokrri detyrën e kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës e mori më 16 shkurt 2008, ku gjatë kohës sa ishte kryetar, futbolli i Kosovës u pranua në UEFA dhe FIFA.

### Zbulohet buceta e shtatores së Fadil Vokrrit

Në stadiumin "Fadil Vokrri" me nderime të larta është zbuluar buceta e shtatores fituese e legjendës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin familjarët e Fadil Vokrrit, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ministrja e Sportit, Vlora Dumoshi, ish-ministrat Memli Krasniqi, Kujtim Shala dhe Kujtim Gashi, si dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës. Kryeministri Hoti në manifestimin e organizuar nga MKRS-ja ka thënë se ky moment është i veçantë pasi të gjithë ne që jemi rritur me legjendën e futbollit, Fadil Vokrrin, ia kemi borxh familjes së tij për të treguar të gjitha nderimet për legjendën, i cili ka bërë historinë më të re të Kosovës edhe në sport, me punën që bashkë me ministrin e atëhershëm, me qeveritë e mëparshme, të gjitha këto aktivitete që janë kryer për ta çuar Kosovën aty ku e ka vendin, në FIFA dhe UEFA. "Është një sukses i jashtëzakonshëm që i është dashur qeverisë dhe shtetit të Kosovës. Pa dyshim, Vokrri mbetet legjenda edhe për brezat që vijnë. Ne jemi të nderuar që sot e bëjmë zbulimin e maketit për shtatoren e Vokrrit, para së cilës në të ardhmen do të përkulen sportistët dhe legjendat e ardhshme të futbollit", ka thënë Hoti.

## Ronaldinho, pas lirimit nga burgu: Barça dhe unë jemi të bashkuar përgjithmonë

BARCELONË, 9 QERSHOR - Ish-futbollisti i Barcelonës, Ronaldinho, ka folur pas 60 ditëve që kaloi në burg. Ylli brazilian u arrestua në Paraguai pasi u përpoq të hynte në këtë shtet me një pasaportë të falsifikuar. Ronaldinho ka vendosur të flasë për këtë aventurë në një intervistë për "Mundo Deportivo". "Kanë qenë 60 ditë shumë të gjata. Njerëzit në shtëpi nuk mund ta imagjinojnë se si është të mos bësh gjërat që t'i do dhe që je mësuar të bësh". 40-vjeçari pasi doli nga burgu qëndroi së bashku me vëllanë e tij në një nga hotelet e klubit të Barcelonës në Paraguai dhe falënderoi katalanasit dhe çdo njeri që ju gjend pranë. "Është një përvojë që do të rrijë përgjithmonë në mendjet tona. Përfundimisht Barcelona dhe unë jemi të bashkuar përgjithmonë. Është ekipi më i mrekullueshëm në botë me tifozët më të mirë në botë", ka shtuar Ronaldinho.



# Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll grumbullohet në gusht

